

Prof. Ass. Dr. Arben Arifi
Kolegji, "UBT", PRISHTINË

**KËRKESA SHQIPTARE NË PARIS, MË 1919, PËR
ARDHJEN E USHTRISË AMERIKANE NË RUGOVË, PLAVË E
GUCI, PËR T'I NDALUR MASAKRAT SERBE E MALAZEZE**

Shkurtore

Lufta e Parë Botërore ishte me pasoja të rënda për shqiptarët. Shqipëria si shtet i brishtë i krijuar në vitin 1912 pati fatin e keq të përfshihet në luftëra ballkanike pa e bërë një vit të plotë nga pavarësia. Pjesa dërrmuese e shqiptareve ishin jashtë shtetit shqiptar pa mbrojtje dhe të shtypur si nga Perandoria Osmane që po numëronte ditët e fundit po ashtu edhe nga vendet fqinje. Edhe gjeopolitika ishte në disfavor të tyre. Gjatë LPB, shqiptarët patën fatin e keq të jenë pre e apetiteve të vendeve fqinje, si dhe si pasojë e mungesës së mbështetjes së fuqive të mëdha, ata pësuan rëndë. Banorët e Rugovës, Plavë e Gucisë dhe e rajoneve të tjera në kufi më malazezët u bënë cak i sulmeve dhe i një fushate të egër e shoqëruar me dëbime dhe masakra rrëqethëse që kulmoi më 16 shkurt 1919. Kjo ishte ndër masakrat më të egra dhe më çnjerëzore që ushtruan serbët dhe malazezët mbi këto anë. Duke e parë që masakrat nuk kanë të ndalur, i gjithë spektri politik shqiptar dhe populli mbarë u vunë në mbrojtje të tyre. Por kjo ishte e pamjaftueshme, sepse fuqitë e mëdha evropiane nuk bënë asgjë për ta ndaluar dhunën dhe e vetmja shpresë ishin ShBA-të. Në këtë kuadër drejt presidentit Wilson u drejtuan shumë kërkesa që ShBA të jenë mandator në vendosjen e paqes dhe sigurisë, sepse ishin të vetmit që shqiptarët i besonin, si dhe ishin i vetmi zë i drejtësisë së paanshme duke u bazuar në parime të demokracisë dhe të drejtës njerëzore.

Fjalët çelësa : Masakrat, Rugovë, Plavë e Guci, Konferenca e Parisit 1919, ndërhyrja amerikane, Wilson.

Hyrje

Pas luftës së Parë Botërore, në Konferencën e Versajës iu mundësua zgjerimi i MSKS (1 dhjetor 1918) me Marrëveshjen e 28 korrikut 1919. Neni 2 i kësaj marrëveshjeje garantonte të drejtat kombëtare, pa marrë parasysh “prejardhjen, gjuhën, racën ose fenë”. Duhet thënë se edhe në këtë konferencë, Serbia u përkrah hapur nga disa vende europiane të cilat kishin pranuar kundërshtimin e delegacionit serb (5 nëntor 1919) i cili kishte kërkuar riformulim të këtij neni, i cili pas riformulimit thotë: “Rregullat sipas këtij neni vlejnë vetëm për ato territore të cilat iu janë ndarë Serbisë pas datës 1 janar 1913”¹. Me formimin e SKS, për dallim nga gjermanët, hungarezët, sllovakët etj., shqiptarëve nuk iu njoh madje as e drejta e pakicës nacionale. Për shqiptarët u rivendos një regjim terrori dhe eksploatimi, shprehet Branko Horvat.² Edhe në këtë konferencë, ishte dëshmuar se Serbia gëzonte një përkrahje europiane në politikat e saj që aplikonte gjenocidin kundër shqiptarëve në Ballkan, pavarësisht se çfarë shkruhej në marrëveshje. Pas shtrirjes së autoritetit të saj në Kosovë, Serbia, fillon masakrat kudo. Një ndër ato më rrëqethëse është ajo e Shtupeqit që ende mbahen mend nga banorët e Rugovës, të datës 16 shkurt 1919, ku ishin ekzekutuar pa gjyq 842 banorë të saj të moshave prej 1 deri 100 vjeç.³ Këto tmerre të luftërave gjithashtu evokohen nga dokumente të tjera të cilat janë vendosur në arkivin e N. Iorgas. Ajo për masakrat serbo-malazeze në rajonin e Rugovës, Kosovë, në shkurt të vitit 1919 është mjaft sugjeruese. Mbi 800 persona, shumica e grave dhe fëmijëve (të moshës ndërmjet 2-75) u masakruan, u përdhunuan ose u dogjën të gjallë.⁴

¹(Časopis kritiko znanosti, 1989, letnik 17, številka 119/120. Narodna in univerzitetna knjižnica, Ljubljana. f:47)

² HORVAT, B. 1988, f. 43.

³ Shih; Elsie, R., 2009, British Foreign Office document FO 608/46, preserved in the National Archives at Kew, U. K.

⁴ Iorga, N. Institute of History, Iorga-Pippidi Archive, package IV. Cituar sipas Ioan Bolovan, Oana Mihaela Tamas, 2020, f. 208.

Situata ters për shqiptarët që nga luftërat ballkanike

Situata kishte shkuar ters për shqiptarët që nga luftërat ballkanike ku rrjedhat e kohës punonin kundër interesave të tyre. Shteti i brishtë dhe i cinguar shqiptar i vitit 1912 nuk ishte në gjendje të mbrojë as veten e lëre më shqiptarët që mbetën padrejtësishtë jashtë tij. Po e nis me studiuesin Karlo Jean i cili shprehet se gjeopolitika evropiane krijoi një konjunkturë të re ndërkombëtare me shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike, për shkak të interesave të kundërta të Fuqive të Mëdha⁵ në rajon. Fitorja e aleatëve ballkanikë kundër ushtrisë osmane detyroi shtetet evropiane të hiqnin dorë nga ruajtja e status quosë në gadishull dhe si rrjedhojë erdhën edhe ndryshime të shpejta e të pakontrolluara në gjepolitikën dhe gjeostratëjinë e shek. XX në Evropë. Vendet e Antantës përkrahën planet e aleatëve për ndryshime territoriale në kurriz të tokave shqiptare. Fakt që u kundërshtua nga fuqitë e Lidhjes Tripalëshe, në mënyrë të veçantë Austro-Hungaria dhe Italia. Ato e konsideronin Shqipërinë si një gardh që do të pengonte përhapjen e pansllavizmit dhe si një bazë për shtrirjen e influences së tyre politike dhe ekonomike në Ballkan, dhe kjo do të ndryshonte përfundimisht pas LPB-së ku shkatërrohen tri Perandoritë: Austro-Hungareze, Osmane dhe ajo e Romanovëve. Mosmarrëveshjet midis Fuqive të Mëdha dhe lufta e popullit shqiptar kundër zgjedhës së huaj diktuan shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912 në Vlorë, nga atdhetari dhe diplomati i njohur Ismail Qemali.⁶ Në dëm të shqiptarve shkuan edhe rrjedhat e mëtutjeshme edhe gjatë LPB-së, edhe pas saj. Nën mbrojtjen e Austro-Hungarisë, Shqipëria nuk u krijua për të ruajtur baraspeshën e ndikimeve dhe për të lehtësuar ndarjen e Ballkanit, por për të mos lejuar Serbinë të siguronte një port në Adriatik. Në anën tjetër Rusia e këshillonte Beogradin të tregohej i matur, ndonëse kishte filluar përgatitjet ushtarake.⁷ Këto politika ishin të domosdoshme në njerën anë për A-H që të ruante Perandorinë e saj, të mbronte zotërimet e saj dhe te ndiqte

⁵ Karlo, J., 1998, f. 89

⁶ *Historia e popullit Shqiptar, Vëll. 2*. Tiranë, 2002, f. 514-515

⁷ Jaray, G. L., 2007, f. 201-211

kursin Drang nach östen (depertimi në Lindje)⁸ përderisa në anën tjetër interesat e Ruisë si forcë në rritje me të cilën nuk donin të ngatërroheshin as Fuqitë e Mëdha u vendos që të priset bilanci pasi që nuk shihnin më interes që të mbahej në jetë i sëmuri i Bosforit⁹ - Perandoria Osmane. Këtu , në këtë vorbull asesesi nuk mund që të mos përfshihej edhe Italia, vend fqinj, e cila ishte shumë e interesuar t'i realizonte aspiratat e saj që ia garantonte edhe Traktati i fshehtë i Londrës i vitit 1913.

Roma e justifikonte zbarkimin e trupave të saj në qytetin e Vlorës

Pas fillimit të LPB, Roma e justifikonte zbarkimin e trupave të saj në qytetin e Vlorës me pretekstin e mbrojtjes së vendimeve të Londrës së 1913-ës për Shqipërinë. Por, zotërimi i bregdetit shqiptar kërkonte angazhimin e Italisë në luftë përkrah Bllokut të Antantës. Për këtë qëllim u nënshkrua Traktati i Fshehtë i Londrës, më 26 prill 1915, në të cilin Anglia, Franca dhe Rusia merrnin përsipër të përmeshnin synimet politike dhe territoriale të Italisë në Adriatikon lindor.¹⁰ Nga ana tjetër, Beogradi, për të realizuar daljen në det nëpërmjet tokave shqiptare, mësyu në Shqipërinë e Mesme. Në qershor 1915, ushtria malazeze pushtoi Shkodrën me rrethina që kishte rëndësi jetike për mbretin Nikolla i Cetinjës.

Neni 7 i Traktatit ; Në qoftë se Italia merr Trientin dhe Istrën në përputhje me përmbajtjen e nenit 4, Dalmacinë dhe ishujt e Adriatikut brenda kufijve të shënuar në nenin 5 dhe gjirin e Vlorës (nenin 6), dhe në qoftë se pjesa qendrore e Shqipërisë REZERVOHET për të formuar një SHTET të vogël autonom të neutralizuar, ajo nuk do të ketë kundërshtim që pjesët veriore dhe jugore të Shqipërisë të ndahen, po që se këtë e

⁸*Il this as a result of efforts to obtain control of the remarkable highway we have been considering. Facing this easterly spread is the steady southerly progress made by the Balkan countries* Me qëllim që të kundërshtojnë panslavizmin, vektorin e ndikimit rus mbi popullatat, në veçanti te serbët, dhe për të parandaluar që Serbia të arrijë Adriatikon (qëllimi i arritur me krijimin në vitin 1913 nga një Shqipëri e pavarur falë veprimit unifikues të të dërguarit Austro-Hungarez Franz Nopcsa)

⁹ *I sëmuri i Bosforit* , quhej Perandoria Otomane në fund të shekullit XIX .

¹⁰ Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë (AIH), A.V.51, Fl. 66 (*Shqipëria nga Hodgson, Londër, prill 1944*)

dëshirojnë Franca , Britania e Madhe dhe Rusia, midis Malit të Zi , Serbisë dhe Greqisë. Bregdeti , duke filluar nga kufiri jugor i zotërimit italian të Vlorës (neni 6) gjer në kepin Stillo (s) , do të neutralizohet. Italia do të ngarkohet që ta përfaqësojë shtetin e Shqipërisë në marrëdhëniet e saj me botën e Jashtme. Italia pranon, nga ana tjetër , ta lërë , në çdo rast , në lindje të Shqipërisë një territor të mjaftueshëm për të siguruar qenien e një kufiri të përbashkët midis Greqisë dhe Serbisë në përfundim të Liqenit të Ohrit, duke mos i prishur interesat e të dyja palëve aspiruese në tërë liqenin. Ministria e Jashtme italiane telegrafon Shtabin e Përgjithshëm të ushtrisë, Ministrinë e Luftës, Legatën italiane në Beograd, se është informuar nga Komandanti i trupave italiane në Shkodër, Perricone, se në datën 7 dhjetor 1919, ka marrë informacion se në Malsinë e Gjakovës disa agjentë të Esat Pashës bashkë me serbë po rekrutojnë shqiptarë për të shpallur qeverinë e re shqiptare. Këtyre agjentëve u janë dhënë edhe lekë.¹¹

Greqia, Italia e Serbia i kishin shkelur vendimet e Londrës për Shqipërinë

Por ai që ishte më afër dhe që iu dha mundësia më e madhe për të vepruar ishte, pa dyshim, Mali i Zi. Aspirata e vjetër e mbretit Nikolla të Malit të Zi, “ëndrra e tij e shenjtë e gjithë jetës”, Shkodra, bëri që ai të nisë drejt saj forcat më të zgjedhura ushtarake, anipse ato ishin aq të domosdoshme në frontin kundër Austro-Hungarisë. Kur tri vendet fqinje (Greqia, Italia e Serbia) i kishin shkelur vendimet e Londrës për Shqipërinë, edhe shteti i vogël malazez, vendosi të merrte pjesën që “i takonte”.¹² Me gjithë statusin e veçantë të administrimit ndërkombëtar që gëzonte Shkodra, pas një rrethimi disaditor, ajo u pushtua nga malazezët me 27 qershor 1915. Mbreti Nikolla deklaroi se ishin shkodranët që i kishin kërkuar të futej në qytet. Në të vërtetë, disa ditë më parë shkodranët i drejtuan një thirrje Eduard Grejit, ministrit të jashtëm anglez ku i luteshin t’i mbronin nga hordhia e padisiplinuar malazeze që po

¹¹ Arkivi i MPJ italiane, Telegrafi i Ministrisë së Jashtme Italiane dërguar Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë, Ministrisë së Luftës dhe Legatës italiane në Beograd, nr.33993, Romë 10 dhjetor 1919, Zarfë nr.683, Dosja alb. 105/1, viti 1919-1930.

¹² *Historia e Popullit Shqiptar III*, 2007, f. 81.

turrej mbi ta.¹³ Kështu Regjimi ndërkombëtar i Shkodrës, i përfaqësuar nga Këshilli i Konsujve, pushoi së funksionuari si i tillë.¹⁴

Kështu një luftë evropiane dukej në horizont dhe ishte e pashmangshme. Nga Fuqitë e Mëdha, Britania mbante një qëndrim pajtues, duke shfaqur gadishmërinë për të ndërmjetësuar midis Antantës dhe Aleancës Tripalëshe, që të evitohej një konflikt i armatosur. Franca dhe Rusia ushtronin presion për t'u siguruar aleatëve ballkanikë zotërimin e gjithçkaje që kishin mundur të merrnin në Shqipëri. Përpjekje që u refuzuan nga Austro-Hungaria dhe qeveria italiane e gjermane.

Në planin ndërkombëtar, Shteti i pavarur Shqiptar "shihej me tmerr si fëmija i paligjshëm i diplomacisë austriake, me Italinë që figuronte si mami".¹⁵ Ky rivalitet midis Fuqive të Mëdha dhe aleatëve ballkanikë për zona influence thelloi gjendjen e paqëndrueshmërisë në rajon. Në Konferencën e Londrës u shqyrtuan dy aspekte të çështjes shqiptare: statusi i ardhshëm politik dhe caktimi i kufijve të Shqipërisë. Ambasadorët vendosën krijimin e një Shqipërie autonome nën "sovrانيتin ose suverenitetin e sulltanit", vënien nën "garancinë e kontrollin ekskluziv të gjashtë fuqive" dhe shpalljen e asnjësisë. Ky vendim i faktorit ndërkombëtar shënonte një trajtim të problemit shqiptar duke shpërfilluar arritjen e Kuvendit të Vlorës, që proklamoi shkëputjen nga Turqia dhe pavarësinë e plotë të vendit. Përfaqësuesit e Austro-Hungarisë dhe të Italisë u ngarkuan me përpilimin dhe prezantimin e një projekti për organizimin e shtetit autonom shqiptar.¹⁶

Territori i Kosovës u aneksua në Mbretërinë e Serbisë. Ky veprim është bërë përkundër faktit që ish-Vilajeti i Kosovës definitivisht kishte shumicën shqiptare në atë kohë.¹⁷ Deri në fund të vitit 1915, territori i shtetit serb ishte pushtuar, nga njëra anë, nga ushtria e Perandorisë Austro-Hungareze dhe nga ana tjetër e ushtrisë bullgare. Qeveria serbe dhe mbetjet e forcave serbe ikën në ishullin e Korfuzit. Në tre vitet e ardhshme, Mbretëria e Serbisë, duke përfshirë Kosovën, ishte nën okupimin austro-hungarez dhe bullgar. Në përbërjen e trupave më së

¹³ Duka, V. 2007, f. 86

¹⁴ *Historia e Popullit Shqiptar III*, f. 82.

¹⁵ Swire. J. 2005, f. 128, 130

¹⁶ *Historia e popullit Shqiptar, vëll. 3.* 2007, f. 20

¹⁷ Juhász J. 1999, f. 13.

shumti franceze dhe serbe, ushtria britanike e Ballkanit e çliroi territorin e shtetit serb deri në fund të shtatorit 1918. Gjatë tetorit dhe nëntorit të vitit 1918, politikanët sllavë jugorë (serbë, kroatë, sllovenë, malazez) negociuan për krijimin e një shteti sllav të Jugut.¹⁸

Kosova duhet t'i përkasë shtetit shqiptar

Këto zhvillime çuan në shpalljen e formimit të të ashtuquajturës Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve më 1 dhjetor 1918, në Beograd. Qeveria e përkohshme e Shqipërisë, në marrëveshje me politikanët shqiptarë në Kosovë, miratoi qëndrimin në vitin 1918-1919 se Kosova duhet t'i përkasë shtetit shqiptar.¹⁹ Por kjo kërkesë shqiptare u injorua nga serbët (dhe fuqitë fitimtare të Antantës, natyrisht) dhe Kosova u bë pjesë e Mbretërisë së sapo formuar të SKS.²⁰ Me dekretin e tij të janarit 1919, Mbreti Aleksandër e ndau vendin në tetë krahina (Serbia, Mali i Zi, Vojvodina, Maqedonia, Bosnjë-Hercegovina, Dalmatia, Kroacia dhe Sllovenia). Siç shihet në listë, Kosova nuk kishte marrë statusin e vet provincial.²¹ Arsyeja është se Beogradi e caktoi këtë zonë ishte pretendimi se Kosova një vend serb i vjetër, në krahinën e Serbisë. Beogradi e trajtoi Kosovën së bashku me Maqedoninë, zakonisht duke iu referuar këtyre rajoneve si Jugu i Serbisë.

Nëse e shohim edhe sot ka ngelur i njëjti kurs nga Serbia e cila ne kushtetutën e saj e quan Kosoven si *Juzna Pokrajina Kosovo i Metohija, e cila ende e mohon gjenocidin e deri tek tentativat që ata kanë qenë viktimat dhe se po bëjnë "koncesione" ndaj Kosovës në dialogun që sot po zhvillohet. Nuk po flasim këtu që termi fyes Metohija që d.m.th. Pronë e Kishës vazhdon të përdoret në vazhdimësi. Kjo na kujton Naçertanijen e vitit 1844 ku po e njëjta Kishë bashkë me Akademinë e Shkencave e hartuan platformën për çfarosjen e popullit shqiptar. Po e përmend këtë si tregues se çfarë kanë në mendje sot serbët edhe përkundër faktit se NATO bombardoi caqet serbe edhe përkundër asaj që palë*

¹⁸ Gulyás L. 2008 Délszláv er"oközpontonk államszervezési koncepcióinak küzdelme 1914–1918, in: Mediterrán és Balkán Fórum, 4, 8, f. 12–21.

¹⁹ Gyémánt R. –TIBOR, P. A. 2008, f. 52.

²⁰ Kitanics M. 2011, f. 25.

²¹ Gulyás L. 2005, f. 82–83.

ndërmjetësuese negociuese janë SHBA dhe UE prapë i shfaq hapur apetitet e saj në vënd që të pranojë fajin dhe të kërkojë falje për gjenocidin që kanë bërë që nga Naçertanija e deri në luftën e fundit në vitin 1998-99. Nëse, ne e bëjmë një paralele me pozicionin që e kishte në vitin 1919 Serbia dhe Mali i Zi mund të kuptojmë se çfarë katrohure kanë kaluar shqiptarët e veçanërisht rugovasit.

Shqiptarët me të drejtë i drejtohen SHBA-ve për ndihmë

Nga kjo shqiptarët mësuan që ishin të pambrojtur dhe asnjë fuqi e madhe nuk ishte e interesuar që t'i mbronte ata. Fatëkeqësisht kjo situatë vazhdoi t'i përcjellë shqiptarët edhe pas LPB-së ku shqiptarët me të drejtë i drejtohen SHBA-ve për ndihmë, sepse e dinin nga përvoja që ato janë e vetmja shpresë për t'u dalë në ndihmë. Pas LPB-së Diplomacia uillsoniane e përbuzte konceptin e ekuilibrit të forcës dhe ushtrimin e *Realpolitikës* e konsideronte të pamoralshëm. Kriteret e Amerikës për rendin botëror ishin demokracia, sigurimi kolektiv dhe vetëvendosja - prej të cilave asnjëra nuk ishte përdorur për ndonjë zgjidhje të mëparshme evropiane. Për amerikanët, disonanca midis filozofisë së tyre dhe mendimit evropian, vinte ne dukje meritat e besimit të tyre. Duke shpallur distancimin nga parimet dhe përvoja e Botës së Vjetër, ideja e Wilsonit për një rend botëror vinte nga besimi amerikan në natyrën e njeriut, në thelb paqësore, dhe harmonia e brendshme e botës. Sipas doktrinës së tij liberale dhe kristiane, ...kur të gjithë popujt e botës ta kenë shijuar bekimin e paqes dhe të demokracisë, ata me siguri do të ngrihen të gjithë së bashku për të mbrojtur fitoret e tyre.²²Përpos SHBA-së, edhe aleatët evropianë kishin luftuar, siç shpallnin ata, për drejtësi, liri dhe për një diplomaci të re; domethënë për të drejtën e vetëvendosjes; por në të vërtetë ata i kishin konsoliduar aleancat në kuadër të kursit të vjetër të marrëdhënieve ndërkombëtare²³ Shtetet e Bashkuara do të ishin, ne fund të fundit, "populli i vetëm pa interesa në Konferencën e Paqes" përveç se ishin të interesuara që të imponoheshin ne rendin e ri botëror me parimin e të drejtave dhe barabarësisë njerzore. Kjo sipas meje është edhe arsyeja kryesore që amerikanët nuk kanë ku të gjejnë shembull më

²²Kissinger H. 1999, f. 221-222.

²³Swire J. *op. cit.* f. 231.

të mirë të shkeljes së të drejtave sesa shembullin e shqiptarëve. Prandaj Masakra e Shtupeqit e vitit 1919 ishte rast shumë tipik i dhunës shtetërore ndaj shqiptarëve. Në dallim nga kombet e tjera, SHBA-ja nuk kishte hyrë në luftë për arsye egoiste, sepse ajo nuk kërkonte territore,tribute ose hakmarrje".²⁴ Në anën tjetër Britania ishte e vendosur për të ruajtur me çdo kusht zotërimet e saj koloniale, pra Perandorinë Britanike, në shkelje të plotë me parimin e vetëvendosjes së popujve. Kurse Franca e G. Clemenceau-së, edhe pse kishte dalë fituese, ishte në një gjendje ekonomike, politike dhe morale tejte të rëndë dhe të dobësuar. Më shumë ajo luftonte për të mbrojtur identitetin e saj,²⁵ në marrëdhënie të ngushtë me Amerikën dhe Britaninë, por që donte të përfitonte terrenin në Ballkan pas rënies së Austro-Hungarisë. Ndërkaq, Italia, e renditur përkrah Antantës, kërkonte përmbushjen e premtimeve nga aleatët, të përcaktuara në marrëveshjen sekrete të prillit 1915, që kushtëzonte fillimin e konfliktit midis Romës dhe Beogradit²⁶, jo vetëm për shkak të politikës ekspansioniste në Dalmaci, por edhe synimeve për të pasur ndikim më të madh në Shqipëri ku Serbia i prishte punë. Mirëpo, avancimi i vendeve sllave nuk u prit mirë nga Franca dhe Anglia, të cilat i konsideronin si përçuese të ndikimit rus në Ballkan. Më 1916, pushtuesit austro-hungarezë proklamonin se kombi shqiptar do të siguronte autonominë atëherë kur të ishte i aftë për t'u vetëqeverisur. Ndërkaq, grekët dogjën 360 fshatra në Shqipërinë e jugut, duke mbytur të gjithë ata që dëshmonin se ishin shqiptarë.²⁷

Pra, politika franceze ishte të dominonte në terren dhe të fuste në lojë Romën dhe Beogradin në mënyrë që ajo të shrinte me shpejt ndikimin e vet. Këtu, normalisht, që shqiptarët do të ishin humbës, sepse Franca favorizonte Serbinë e cila po faktorizohej më shumë dhe vetë krijimi i MSKS ishte arsyeja pse ajo e mbështeste.

²⁴ Macmillan M. *op. cit.*, f. 37

²⁵ Bashkurti L. 2003, f. 166.

²⁶ Cabanes, Chaline, Doumerc, 2005, f. 477.

²⁷ Bumçi L. 1920, f. 12.

Shkodra u bë vatra kryesore ku gjetën strehim shqiptarët

Pas Luftës së Parë Botërore, Shkodra u bë vatra kryesore ku gjetën strehim shqiptarët nga Shqipëria Verilindore (Kosova), dhe ajo Veriperëndimore (Malësia). Në Shkodër kishte qendrën e aktivitetit të saj organizata në mbrojtje të çështjes shqiptare: Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Shkodra gjatë muajit mars 1919, ishte ndër qendrat kryesore ku vërshuan refugjatë nga Peja, Gucia e Plava, si rezultat i terrorit serb. Në situatën e brëndshme politike në Shkodër ndjehej fort edhe rivaliteti mes Italisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene për dominim në Adriatik. E gjendur padashur në mes të këtij rivaliteti “ Shkodra ka qenë pjesë e një sistemi të tërë ballafaqimesh dhe intrigash që këto dy fuqi të Adriatikut ushtruan në Veriun e Shqipërisë”.²⁸

Pas LPB-së nuk ka pasur tjetër vend me një territor kaq të vogël që të jetë ndarë atëherë midis fuqive kaq të shumta shprehet Muin Çami.²⁹ Kur u arrit armëpushimi, u vendos që trupat aleate do ta mbanin Shqipërinë të pushtuar derisa fati i saj të përcaktohej nga Konferenca e Paqes. Të parat që pushtuan Shkodrën qenë trupat serbe, por ky pushtim zgjati pak. Këshilli Suprem i fuqive aleate, që mbledhej në Versajë në nëntor 1918, përcaktoi evakuimin e të gjithë territorit të Shqipërisë prej trupave serbe dhe pushtimin prej një trupe ndërkombëtare të qytetit të Shkodrës.³⁰

Lëvizja Kombëtare në Shkodër, qe e detyruar të ishte në gadishmëri për të goditur sa planet italiane aq edhe ato serbe. Në fund të korrikut 1919, trupa të rregullta jugosllave kapërcyen kufirin në Qafë të Morinës dhe pushtuan zonat e Krasniqes, të Gashit, Nikajt e Mërturit³¹ duke iu afruar krahinës së Shkodrës.

²⁸ Gurakuqi R. 2007, f. 105.

²⁹ Çami M. 1978, nr.4, f. 61..

³⁰ Gurakuqi R. 2007, f. 16.

³¹ AQSH, Fondi nr. 846, viti 1919, dosja 13, f. 1.

Kronologjia e pushtimit të Shkodrës

Kronologjia e pushtimit të Shkodrës ka qenë e tillë: trupat serbe hynë të parat në qytet më 30. 10. 1918³², të nesërmen më 31 tetor arritën trupat italiane, më 5 nëntor hynë ushtritë franceze që vinin nga Gjakova³³ duke ia dorëzuar Kosovën Komandës Supreme të forcave serbe³⁴, komandanti i tyre Bardi de Fourtou arriti më 16 nëntor³⁵, ndërsa në dhjetor mbërriti edhe kontigjenti anglez. Garnizoni ndërleat që u vendos në Shkodër, do të kishte një kohëzgjatje të përkohshme, derisa Konferenca e Paqes të përcaktonte të ardhmen politike të qytetit e të Shqipërisë së Veriut³⁶.

Pra synimi i trupave serbe ishte që të paralizonin Shkodrën epiqendrën tek e cila mbështeteshin shqiptarët e Kosovës në mënyrë që të vazhdojë lirshëm me gjenocidin që kishte filluar atje. Kështu serbët dhe malazezët do t'i kenin duart e lira për ta vërë në jetë planin e tyre kur tashmë ishte larguar edhe një kontigjent i forcave franceze nga Gjakova. Para kësaj ata po u linin duart e lira serbëve për t'i jetësuar planet e tyre sipas parimit *laissez faire*. Fillimisht serbët filluan me aksionin famëkeq për mbledhjen e armëve që filloi më 9 nëntor 1918 dhe brenda një periudhe të shkurtë kjo valë i përfshiu të gjitha territoret e zonës serbe. Sipas studiuesit Lush Culaj serbët me qëllim të hutimit dhe demoralizimit të popullit shqiptar, i filloi ndjekjet kundër prijësve të Levisjes Kombëtare Shqiptare. Për t'u shpëtuar ndjekjeve dhe torturave, disa prej tyre u detyruan të largohen nga territori i Kosovës. Pjesa më e madhe e tyre shkoi në Shkodër, kurse pjesa tjetër në viset shqiptare të Shqipërisë dhe në disa vende të tjera të Evropës.³⁷ Marrja e armëve e humbte fuqinë mbrojtëse të shqiptarëve dhe u krijonte komoditet serbëve e malazezve për të kryer masakra mbi një popullatë të pambrojtur, këtë e vërteton edhe rasti i Masakrës së Shtupeqit të shkurtit të vitit 1919.

³²AQSH, Fondi "Hoxha Kadriu", dosja nr. 2, dok. nr. 708197.

³³"Besa Shqiptare", Shkodër, nr. , dt 7. 11. 1918.

³⁴HadriA.1974, f.39; Pushkolli F. 1991, f. 77; HrabakB. 1971 f. 256-257.

³⁵Repishti Xh. *op.cit.* f. 65.

³⁶*Historia e Popullit Shqiptar III*, f. 97.

³⁷Culaj L. 2010, f.42.

Territori i Kosovës u aneksua në Mbretërinë e Serbisë. Ky veprim është bërë përkundër faktit që ish-vilajeti i Kosovës definitivisht kishte shumicën shqiptare në atë kohë.³⁸

Deri në fund të vitit 1915, territori i shtetit serb ishte pushtuar, nga njëra anë, nga ushtria e Perandorisë Austro-Hungareze dhe nga ana tjetër nga ushtria bullgare. Qeveria serbe dhe mbetjet e forcave serbe ikën në ishullin e Korfuzit. Në tre vjetët e ardhshëm, Mbretëria e Serbisë, duke përfshirë Kosovën, ishte nën okupimin austro-hungarez dhe bullgar. Në përbërjen e trupave më së shumti franceze dhe serbe, ushtria britanike e Ballkanit e çliroi territorin e shtetit serb deri në fund të shtatorit 1918. Gjatë tetorit dhe nëntorit të vitit 1918, politikanët sllavë jugorë (serbë, kroatë, sllovenë, malazezë) negociuan për krijimin e një shteti sllav të Jugut.³⁹ Këto zhvillime çuan në shpalljen e formimit të ashtuquajturës Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve më 1 dhjetor 1918, në Beograd. Qeveria e përkohshme e Shqipërisë, në marrëveshje me politikanët shqiptarë në Kosovë, miratoi qëndrimin në vitin 1918-1919 se Kosova duhet t'i përkasë shtetit shqiptar.⁴⁰ Por kjo kërkesë shqiptare u injorua nga serbët (dhe fuqitë fitimtare të Antantës, natyrisht) dhe Kosova u bë pjesë e Mbretërisë së sapo formuar të SKS.⁴¹

Me dekretin e tij të janarit 1919, Mbreti Aleksandër e ndau vendin në tetë krahina (Serbia, Mali i Zi, Vojvodina, Maqedonia, Bosnjë-Hercegovina, Dalmatia, Kroacia dhe Sllovenia). Siç shihet në listë, Kosova nuk kishte marrë statusin e vet provincial.⁴²

Arsyeja është se Beogradi e caktoi këtë zonë, duke e konsideruar si një vend serb i vjetër, në krahinën e Serbisë. Beogradi e trajtoi Kosovën së bashku me Maqedoninë, zakonisht duke iu referuar këtyre rajoneve si Jugu i Serbisë.

Nëse e shohim edhe sot ka ngelur i njëjti kurs nga Serbia e cila në kushtetutën e saj e quan Kosovën si *Juzna Pokrajina Kosovo i Metohija, e cila ende e mohon gjenocidin e deri te tentativat që ata kanë qenë viktimat dhe se po bëjnë "koncesione" ndaj Kosovës në dialogun që sot*

³⁸Juhász J. 1999, p. 13.

³⁹Gulyás L. 2008, pp. 12–21.

⁴⁰Gyémánt R. –Tibor P. 2008, f. 52.

⁴¹Kitanics M. 2011, f. 25.

⁴²Gulyás L. 2005, f. 82–83.

po zhvillohet. Nuk po flasim këtu që termi fyes Metohija që d.m.th. pronë e kishës vazhdon të përdoret në vazhdimësi. Kjo na kujton Naçertanijen e vitit 1844 ku po e njëjta kishë bashkë me Akademinë e Shkencave e hartuan platformen për shfarosjen e popullit shqiptar. Po e përmend këtë si tregues së çfarë kanë në mendje sot serbët edhe përkundër faktit se NATO bombardoi caqet serbe edhe përkundër asaj që palë ndërmjetësuese negociuese janë SHBA dhe UE prapë i shfaq hapur apetitet e saj në vend që të pranojë fajin dhe të kërkojë falje për gjenocidin që kanë bërë që nga Naçertanija e deri në luftën e fundit në vitin 1998-99. Nëse ne e bëjmë një paralele me pozicionin që e kishte në vitin 1919 Serbia dhe Mali i Zi, mund të kuptojmë së në çfarë krahure kanë kaluar shqiptarët e veçanërisht rugovasi. Nga kjo del që Aleatët, dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe, vazhdimisht i vendosën të drejtat e kombësive të vogla në ballë të qëllimeve të tyre të luftës. Ky edhe ishte shpëtimi i shqiptarëve, sepse çështja shqiptare po futej në agjendat e fuqive të mëdha edhe pse në planin sekondar. Gjatë negociatave të armëpushimit ata në mënyrë eksplicite morën shtetësinë dhe vetëvendosjen si parimet udhëheqëse të zgjidhjes përfundimtare.⁴³

Pakënaqësia bullgare kundër Serbisë dhe Greqisë e përjetësuar, do të çonte në një afrim me Italinë, synimet e të cilës ishin në Dalmaci, Shqipëri jugore dhe konfliktit të Azisë të Vogël me ambicjet serbe dhe greke. Ekuilibri i pushtetit i këtij lloji do të ishte si një rrezik i madh për paqen e Evropës dhe të ardhmen, rivaliteti austro-rus ishte nga e kaluara. Ende pati ujëra të trazuar në të cilat fuqitë qendrore mund të peshkonin.⁴⁴ Kështu gradualisht të drejtat e kombësive të vogla që në fillim viheshin në ballë të qëllimeve të tyre të luftës u pa se ishin farsa të radhës për shkak se interesi i tyre ishte më i madh. Vetëm SHBA do t'i qendrojë besnike këtij parimi deri në fund.

⁴³ Noel Buxton and C. Leonard Leese, 1919, f.109.

⁴⁴ Shih; H. N. Bradford, 1919.

Golgota dhe vuajtjet nuk pushuan edhe pas Konferencës së Parisit

Por edhe pas gjithë kësaj golgota dhe kalvarët e gjata të vuajtjeve nuk pushuan edhe pas Konferencës së Parisit. Fushatat e egra të MSKS-së nuk u ndalen, por tash e kishin siguruar që të mos u përzihej askush. Dua ta përmbyll me disa shifra të gjata të të masakruarëve dhe të vrarëve në rajonët Plavë, Guci, Rugovë e Podgor të Pejës gjatë viteve 1919-1920. Sipas Tahir Zaimit, 19 450 shpirt[ra të tjerë shqiptarësh në Plavë, Guci, Rugovë e Podgor të Pejës, u masakruan gjatë vitit 1919.⁴⁵ Ndërkaq, si rezultat i gjenocidit të ushtruar gjatë vitit 1920, në 41 fshatra të Plavës dhe Gucisë, rezultojnë të mbytur 4 066 veta, nga këta 954 gra dhe 1 046 fëmijë, 6 050 banesa të djegura, 73 884 krerë bagëti të imta dhe 17 842 bagëti të trasha të grabitura.⁴⁶ Edhe me gjithë faktin që aleatët, dhe veçanërisht Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vazhdimisht i vendosën të drejtat e kombësive të vogla në ballë të qëllimeve të tyre të luftës. Gjatë negociatave të armpushimit ata në mënyrë eksplicite morën shtetësinë dhe vetëvendosjen si parimet udhëheqëse të zgjidhjes përfundimtare.⁴⁷

Pakënaqësia bullgare kundër Serbisë dhe Greqisë e përjetësuar, do të çonte në një afrim me Italinë, synimet e cilës ishin në Dalmaci, në Shqipëri jugore dhe nëkonfliktin te Azisë së Vogël me ambiciet serbe dhe greke. Ekuilibri i pushtetit i këtij lloji do të ishte si një rrezik i madh për paqen e Evropës dhe të ardhmen, rivaliteti austro-rus ishte nga e kaluara. Ende pati ujëra të trazuara në të cilat fuqitë qendrore mund të peshkonin.⁴⁸

Kështu gradualisht të drejtat e kombësive të vogla që në fillim viheshin në ballë të qëllimeve të tyre të luftës u pa se ishin farsa të radhës për shkak se interesi i tyre ishte më madhor. Vetëm SHBA do t'i qendrojë besnike këtij parimi deri në fund.

Ndërsa Austro-Hungaria u shua në vjeshtën e vitit 1918, në Konferencë të Paqes e cila pasoi luftën, Whitehall u kthye drejtpërdrejt te

⁴⁵Zaimi, T. 1970, f. 105-106.

⁴⁶BrahaSh. 1991, f. 283-284.

⁴⁷Noel Buxton and C. Leonard Leese f.109.

⁴⁸Shih; H. N. Bradford, 1919.

Seton-Watson për të kuptuar trazirat aktuale dhe rindërtimin e ardhshëm të kësaj perandorie të fragmentuar dhe të rajonit më të gjerë ballkanik.⁴⁹ Siç vuri në dukje Robert Evans, në periudhën e pasluftës, me Gjermaninë edhe Rusia u përul, "tokat në mes" fituan një rëndësi të paprecedentë të drejtën e tyre; prandaj nuk është për t'u habitur që viti 1919-20 shënoi 'momentin kulmor të intensitetit' për bashkëpunimin midis Foreign Office dhe grupit në rritje të ekspertëve të pavarur në këtë fushë.⁵⁰ Një tjetër historian ishte Harold Temperley, një mik afatgjatë i Seton-Watson, i cili i fundit ndau pikëpamjet e tij mbi vetëvendosjen kombëtare dhe entuziazmin e tij për sllavët e Jugut në veçanti. Njohuria e Temperley mbi Serbinë (e regjistruar në librin e tij "Historia e respektuar") e pa atë të punësuar në qershor 1917 si kreu i MI2, organizatë e re kërkimore e krijuar nga Drejtoria e Ushtarake e Inteligjencës dhe më pas si anëtar i delegacionit të Konferencës britanike. Në Serbi nga mesi i tetorit 1918 dhe prill 1919, Temperley prodhoi raporte për situatën jugosllave dhe në mënyrë të dukshme për qëndrimet formale zyrtare, brenda dhe jashtë Foreign Office.⁵¹

Shqiptarët kanë pasur të drejtë që u janë drejtuar SHBA-ve për ndihmë

Nga këtu shihet që shqiptarët kanë pasur të drejtë që u janë drejtuar SHBA-ve për ndihmë, sepse e vetmja shpresë mbetën ato pasi që tash edhe mbeshtetja britanike edhe ajo franceze ishin pro Serbisë dhe Malit të Zi në raport me shqiptarët. Për çudi i vetmi popull i ballkanit që nuk fitoi asgjë ishin shqiptarët, por që ishin populli i vetëm në Ballkan, të cilit iu bë padrejtësi dhe ushtrohej dhunë mbi të. Por qëndrimi britanik mund të lidhet edhe me monopolin e saj politik duke mos dashur që Franca të ketë ndikim mbi vendet ballkanike. Nga disa dokumente të Foreign Office nga letrat e diplomatit amerikan Sir George Grahame mesojmë pozicionin francez në raport me Serbinë dhe Malin e Zi.

Ndërkohë, sjellja e aleatëve evropianë të Britanisë po trazonte ujërat. Nga njëra anë Italia ishte e zënë, nga pozicionet në Shqipëri, duke

⁴⁹ R.W. Seton-Watson, 1981. f.105.

⁵⁰ Evans R., 2002, f.6.

⁵¹ H. Seton-Watson, 1976, f. 265-7

nxitur pavarësinë e Malit të Zi në një përpjekje për të minuar një shtet jugosllav. Nga ana tjetër, dëshmitë në rritje të marrëveshjes së fshehtë ndërmjet Beogradit dhe Parisit sugjeruan se Franca po sponsorizonte një Serbi të Madhe për qëllimet e saj (një dyshim i konfirmuar plotësisht nga një studim i fundit francez).⁵²

Refuzimi francez për të paralajmëruar Beogradin jashtë Malit të Zi, siç argumentoi Grahame, ishte 'një provë tjetër' se ministria e jashtme franceze dhe qeveria serbe kishin 'absolutisht gishtë në të'.⁵³ Duke pyetur në Quai d'Orsay për çdo gjë që lidhet me Malin e Zi, "ai ankohet", duket ashtu sikur t'i kërkonte Beogradit.⁵⁴ Në një çast, Lord Derby duartroket në Londër, ai shqyrton implikimet e politikës franceze: Ndoshta gjithë influenza franceze do të përdorej për të bërë jugosllavët [...] që të vijnë nën sundimin serb me sa me pak regjim federativ që është e mundur. Njerëzit më thonë se financat e mëdha, interesat dhe koncesionet bankare tani më janë përfshirë, dhe francezët synojnë që së pari Serbia të jetë sa më e madhe që të jetë e mundur, dhe së dyti, se ajo do të jetë nën sundimin e tyre. Kjo do të thotë se ata do të favorizojnë eliminimin e Malit të Zi në interesin serb dhe të dalë kundër Italisë. Franca do që të jetë fuqia dominuese në kontinent me një 'plejadë' të këtyre shteteve të reja që po formoheshin. [...] Francezet mund t'i bëjnë shërbim vetes së tyre me fjalë të mira në idenë e Lidhjes së Kombeve dhe kështu ata synojnë të përfitojnë maksimumin nga situata jashtëzakonisht e favorshme në të cilën ata tani e gjejnë veten në Evropë.⁵⁵

Delegacioni ynë në Konferencën e Paqes në Paris

Duke e parë situatën paralelisht edhe delegacioni pjesëmarrës në Konferencën e Paqes në Paris gjatë viteve 1919- 1920 nga Shqipëria ishin: Turhan Pasha, Mithat Frashëri, Mihal Turtulli, Imzot Luigj Bumçi dhe Mustafa Kraja,⁵⁶ anëtarë të Qeverisë së Turhan Pashë Përmetit, sipas

⁵² Shih, Grumel-Jacquignon, 1999, f.35; J. Adler, 1997, f.156.

⁵³ James Evans, 2008, f. 131; FO 371/3149/212705 (Grahame, 24 Dec 1918).

⁵⁴ Po aty; FO 371/3149/213092 (Grahame, 27 Dec 1918).

⁵⁵ Shih: D. R. Watson, 1971.

⁵⁶ Imzot Luigj Bumçi dhe Mustafa Kraja u bënë pjesëtarë të këtij delegacioni vetëm pas ndërhyrjes së ministrit të punëve të jashtë të Italisë, Sonin. *Shih*: Duka, 1999, f. 298.

studiueses Valentina Duka, *"në përbërjen e saj u mundua të reflektonte tërë spektrin fetar të shoqërisë"*. *Kjo ishte një lëvizje shumë e qëlluar, sepse i gjithë spektri fetar ishte unik dhe nuk kishte anime, madje Luigj Bumçi në vizitën e tij te Papa lutet për shqiptarët dhe kërkon me ngulm që të mbrohen shqiptarët- populli i tij.*

Qeveria e Përkohshme e Durrësit nëpërmjet Kryetarit të saj Turhan pashë Përmeti në prag të përgatitjeve për Konferencën e Paqes së Parisit, i drejtohej me një telegram Presidentit të Amerikës Wilson, ku kërkohej përkrahja e tij dhe e Amerikës për Shqipërinë, si popull dhe vend më i vjetër i gadishullit të Ballkanit, për të drejtën e pavarësisë dhe integritetit tokësor. Kërkesa përmblihte këto pika:

a) të përfaqësohet Shqipëria në Konferencën e Paqes;

b) të ndihmohet nga Fuqitë e Mëdha aleate;

c) të përfshihen brenda kufijve të atdheut tokat etnike të grabitura nga fqinjët, sipas Konferencës së Londrës 1913".⁵⁷ Delegacioni shqiptar ishte i mendimit që kufijtë e vendit të përcaktur nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër 1913 duheshin konfirmuar, por duhej kërkuar dhe aspiruar kufijtë etnikë sipas shtrirjes gjeografike, e cila fillonte prej gjirit të Spicës (në veri të Tivarit), në verilindje duke përfshirë Tuzin, Hotin, Grudën, Triepshin, Podgoricën, duke ndjekur kufirin me Malin e Zi, duke përfshirë qytetet: Pejë, Gjakovë, Mitrovicë (pjesën lindore), Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Kacanik, pastaj me atë të Maqedonisë, duke përfshirë qytetet: Shkup, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër, për të arritur te Mali i Thatë ndërmjet liqeneve të Ohrit e të Prespës dhe duke përfunduar me majën e malit të Gramozit e duke vazhduar drejt jugut për të dalë afër gjirit të Prevezës.⁵⁸

"Siç shkruante gazeta "Populli" Më 3 tetor 1919, shqipëtarët nuk do të lejojnë një mandat të Italisë në Shqipëri, ata duan pavarësi të plotë të vendit dhe nëse Fuqitë e Mëdha mendojnë se ata nuk janë të aftë të qeverisin vendin pa pasur mbrojtjen e një fuqie të madhe, ata do të kërkonin që kjo fuqi të ishte jo Italia, por Amerika derisa të përgatitej

⁵⁷ Arkivi i MPJ, Dosja 10, Telegram i Kyetarit të Qeverisë së Përkohshme Turhan pashë Përmeti, dërguar Presidentit të Amerikës, datë 3.1.1919, viti 1919, f.6-8.

⁵⁸ Arkivi i MPJ, Dosja 10, Kërkesat e Kyetarit të Qeverisë së Përkohshme Turhan pashë Përmeti në emër të Delegacionit shqiptar drejtuar Konferencës së Paqes së Parisit, datë 12.2.1919, viti 1919, nr.50.948, f.22-26.

terreni për një qeverisje shqiptare. Ka një mendim se Italia kërkon të jetë patrone absolute e Adriatikut dhe të italianizojë Shqipërinë. Kjo vihet re në shkolla ku gjuha italiane është gjuha kryesore e mësimdhënies dhe vetëm 2 orë në ditë bëhet mësim në gjuhën shqipe. Shqiptarët e quajnë veteveten shqiptarë dhe kualifikohen me kombin dhe jo me fenë, siç bëjnë disa vende ballkanike.

Shqipëtarët besojnë tek Amerika e Wilsonit dhe shpresojnë që ai do të ndikojë në vendimarrjen e Konferencës së Paqes për Shqipërinë. Amerika, ndryshe nga sa mendohet se nuk dëshiron të përfshihet në çështjen shqiptare, ka si qëllim të mbajë paqen në Evropë dhe është pikërisht ky moral që e shtyn të merret me kauzën e Shqipërisë, për vendimin e fatit të saj dhe të marrë mandatin e Shqipërisë së kërkuar nga shqiptarët. Shqiptarët e dinë se Italia ka për qëllim të marrë territorin e saj dhe do të bindë me dinakërinë e saj Fuqitë e Mëdha për të marrë mandatin mbi Shqipërinë. Shembujt kanë treguar që kur Fuqitë Evropiane kanë zënë një terren të huaj e kanë marrë në sundimin e tyre, ndërsa Amerika është e vetmja Fuqi që në rastin e Kubës e ka marrë në kontroll, por më pas e ka lëshuar duke ia kaluar në posedim autoriteteve kubaneze. Për këtë arsye Shqipëria nuk mund të jetë nën kontrollin as të Italisë, as të Francës dhe as të Anglisë, por të Amerikës. Amerika ka hyrë të luftë për të siguruar principet e Wilsonit dhe për të shpëtuar demokracinë në botë, dhe jo për qëllime përfitimi siç janë Fuqitë Evropiane”.⁵⁹

Në një artikull të botuar në vitin 1920 në *The Journal of International Relations* thuhet që shumica e shqiptarëve në Paris në vitin 1919 kërkuan që SHBA-të të jenë si mandator i detyrueshëm, gjë që shpesh u kërkuar me urgjencë e lutje që vështirë se mund të dështojë për të pasur rezultate të dëshirueshme në qoftë se ishte e mundur për ta sjellë atë plotësisht dhe në mënyrë të drejtë para publikut amerikan.⁶⁰

⁵⁹ Gazeta "Populli", nr.25, date 3 tetor 1919.

⁶⁰ Albert H. Lybyer, Vol. 10, No. 4 (Apr., 1920), pp. 404-424., f.415.

SHBA-së, t'i jepej mandati për të administruar territorin shqiptar

Nga kërkesat e shumta derguar nga Delegacioni Shqiptar ajo që mban datën 7 mars 1919 thuhet... SHBA-së, t'i jepet mandati legjitim për të administruar territorin shqiptar që është në diskutim, për një periudhë nga dy deri në pesë vjet dhe pas kësaj pasi të ishin marrë masat e nevojshme për ta mbrojtur popullsinë nga kërcënimi dhe propaganda, fati i tyre të vendoset me një plebishit"⁶¹.

Në fillim të vitit 1919 si një fushatë e gjerë, qëllimi i së cilës ishte që ShBA të caktohen nga ana e bashkësisë ndërkombëtare si mandatore mbi Shqipërinë. Se nga kush ka lindur kjo ide, vështirë se mund të thuhet me siguri, por nga dokumentet në dispozicion mund të shihet se të gjithë politikanët shqiptarë ishin dakord për një gjë të tillë. Nga një letër e Federatës Panshqiptare dërguar Robert Lansingut, shef i Departamentit të Shtetit, mund të arrihet në konkluzion se të gjithë emigrantët shqiptarë mendonin për pjesëmarrjen aktive të ShBA-së në zgjidhjen e problemit shqiptar qysh para Konferencës së Parisit. Ata i bëjnë të ditur Lansingut për hapat që kishin marr shqiptarët edhe në SHBA. Ata e njoftuan lidhur më Rezolutën e miratuar në mbledhjen e jashtëzakonshme të Federatës Pan-shqiptare, më datën 4.1.1919 në Boston, me të cilën i bëhet thirrje ShBA-së të merret me vendosjen e sovranitetit shqiptar përsëri nën garancinë e bashkësisë ndërkombëtare. Ata kërkojnë që në të gjitha territoret ku popullsia shqiptare dhe në territoret e diskutueshme të zhvillohet referendum, por kjo pas ardhjes së trupave amerikane, në mënyrë që të sigurohet ajo gjendje në të cilën popullsisë t'i jepet mundësia të shprehet lirshëm⁶².

Me fillimin e Konferencës së Paqes, kjo ide mbi marrjen pjesë të Amerikës në zgjidhjen e çështjes së Shqipërisë u bë më e rregulluar,

⁶¹ Dokumenta zyrtare të paraqitura nga ana e Dërgatës Shqiptare nga datat 12 shkurt deri më 5 qershor 1919, të botuara nga ana e Qeverisë së Përkohshme. Kërkesat e Shqipërisë në Konferencën e Paqes së Parisit 1919 drejtuar Fuqive të Mëdha, Paris, më 12 shkurt 1919, nënshkruar nga Kryetari Turhan pashë Përmeti, Shqipëria përballë Konferencës së Paqes Paris 1919, 2007, f.79-81.

⁶² Dosje e Vudrov Uilsonit Kamburi Lansingut, datë 07.0.1919. cituar nga Haris Silajxhiqi, f.105

sigurisht e lidhur kjo edhe me qëndrimin që mbajti Konferenca ndaj Shqipërisë dhe përfaqësuesve të saj. Në këtë moment, iniciativa për përcaktimin e kërkesave shqiptare dhe për koordinimin e veprimtarisë së të gjithë shqiptarëve në këtë drejtim, i përket Mehmet Konicës, pastaj dr. Adhamidhit dhe Profesor Xhorxh Heronit amerikan me të cilin dr. Adhamidhi kishte lidhje të ngushta. Në një letër drejtuar Nolit, Heron thotë që shqiptarët, nëpërmjet Adhamidhit iniciuan çështjen e një protektorati mbi Shqipërinë dhe kërkojnë që Fred Williams, ish-ambasadori amerikan në Athinë, të përfshihet në këtë fushatë. Sipas kësaj letre, Heroni nëpërmjet përfaqësuesit amerikan në Zvicër, i dergoi Wilsonit të gjithë dokumentacionin që kishte të bënte me këtë çështje.⁶³

Pothuaj po në të njëjtën kohë edhe Adhamidhi i dërgon një letër Nolit, në të cilën deklarohet për rregullimin republikan të Shqipërisë, me një president amerikan, i cili do të ndihmonte në një rregullim administrativ në udhëheqjen e shtetit. Shqiptarët nuk mund të presin që këtë rol ta luajë Anglia ose Franca, për arsye se, siç shprehët ai "I kanë duart e zëna"⁶⁴

Madje edhe vetë Noli, kryetar i atëhershëm i "ËVatrës" ishte për një ndihmë amerikane, por në deklaratën e tij vihet një dozë reserve ndaj ndonjë angazhimi që do t'i kalonte caqet e ndihmës së zakonshme. Ai ishte i mendimit se protektorati Italian, si çdo protektorat tjetër, duke përfshirë këtu edhe atë që Amerika paraqiste rrezik për paqen në Ballkan⁶⁵

Duke pasur të njëjtin mendim me politikanët e kohës, ai ishte i mendimit se asnjë fuqi evropiane nuk është krejtësisht e paanshme që të ndër marrë një rol të tillë. Noli e sheh zgjidhjen në krijimin e një komisioni amerikan, që do të përcaktohej nga qeveria e ShBA-së, detyra e të cilit do të ishte: të "ndihmonte shqiptarët për krijimin dhe vënien në efikasitet të një shteti, ku çdo shqiptar lojal do të ndihej i kënaqur"⁶⁶

Noli ishte i sigurt se shumë shqiptarë, që ishin të detyruar të emigronin në Amerikë, kanë dëshirë të kthehen në atdhe dhe të japin kontribut në zhvillimin e tij "në futjen e koncepteve amerikane të lirisë,

⁶³ N.A. Letër e Heronit dërguar Nolit , 15.02 1918

⁶⁴ Po aty N.A. Letër e Heronit dërguar Nolit , 19.02 1918.

⁶⁵ Komisioni Hetimor, dokumenti nr. 436.

⁶⁶ Po aty.

ekonomisë dhe zhvillimit politik", ta fusnin Shqipërinë në rrugën e rilindjes ekonomike dhe kulturore. Adhamidhi është i mendmit së vetëm ShBA-të mund të marrin në dorë fatin e Shqipërisë dhe të jenë një organizator i suksesshëm i jetës ekonomike dhe kulturore të Shqipërisë. Është mteressant se si Adhamidhi, i cili sikur është ish-përfaqësues diplomatik i Shqipërisë në Romë, delegat i Republikës së Korçës, Kryetar i Komitetit Kombëtar Shqiptar dhe kryetar i shoqërisë "Bashkimi" në Egjipt dhe delegat i "Vatërës" etj. argumenton kërkesën e një mandati amerikan mbi Shqipërinë. Shqiptarët, shkruan Adhamidhi, për nga natyra janë krenarë dhe të pavarur dhe etnikisht kanë rrënjë të përbashkëta me skocezet, prandaj kanë dëshirë të pranojnë t'i drejtojnë funksionarët anglezë dhe amerikanë pasi janë të bindur në sinqeritetin e tyre, sepse e dinë që janë superiorë në raport me kombet e tjera dhe se amenkanet nuk kërkojnë të dominojnë"⁶⁷

Sipas Eriksonit janë "Gjashtë arsye për të cilat Amerika duhet të bëhet mandatore ndaj Shqipërisë"⁶⁸ Arsyeja e parë, sipas Eriksonit është fakti që Amerika hyri në luftë për synime morale. Parimi i mbrojtjes së popujve të vegjël është një nga parimet bazë që ka shpallur presidenti Wilson. Megjithatë, ky parim nuk do të zbatohet në rastin e Shqipënsë veçse kur ta zbatojë Amerika. Arsyeja tjetër është se Amerika, duke pranuar mandatin do të kryente obligimin e Konferencës së Paqes për mbrojtjen e të drejtave të kombeve dhe për vendosjen e kufijve mbi baza etnike. Amerika e ka për detyrë ta pranojë thirrjen e shqiptarëve, të cilët kërkojnë ndihmë, njëlloj sikurse kapiteni i anijes që e ka për detyrë t'i përgjigjet sinjalit S.O.S dhe t'i ofrojë ndihmë anijes që po mbytet. Evropa ende është e bindur, shkruan Eriksoni, se Amerika nuk është "një popull i dashuruar pas arit, një popull materialist, i cili do të shfrytëzojë përparësitë e çastit për të krijuar superioritetin tregtar në botë". Detyra e Amerikës është të mbetet në Evropë që të ndihmojë në çlirimin e popullit shqiptar dhe t'i ndihmojë atij të ngrihet dhe "me bekimin e gjithë botës, të vendosë harmoninë dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në Ballkan"⁶⁹ Delegacioni shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, më datë 7.3.1919 paraqiti kërkesën zyrtare për përcaktimin e ShBA-së si

⁶⁷ Doşje e Vudrow Wilson, Letër e Adhamidhit dërguar Wilsonit, Paris 17.03.1919.

⁶⁸ C.T.Erikson, 1919.

⁶⁹ Po aty.

mandatore të Shqipërisë. Kjo u bë pas degjimit të delegacionit shqiptar para Komisionit për çështjet greke më 27.2.1919 dhe delegacioni shqiptar e vlerësoi si të pakënaqshëm, sepse komisioni la përshtypjen e një mosinteresimi të madh që ka për ne rendësi të madhe dhe nga e cila varet liria ose robëria e qindra –mijëra vëllezërve tanë.⁷⁰

Këshilli i Lartë i Konferencës së Paqes nuk do të pranonte kërkesat shqiptare prandaj delegacioni shqiptar 'në mënyrë që të mbante qindra-mijëra bashkatdhetarë nga fqinjët e tyre' kërkoi që Konferenca e Paqes, me qëllim të organizimit të një plebishiti, t'i besojë ShBA-së një mandat mbi Shqipërinë "për një ose dy vjet" në ato territore për të cilat diskutohej dhe flitej edhe në Memorandumin e datës 12.2.1919. Nga kjo shihet se delegacioni shqiptar kërkonte një mandat amerikan për Shqipërinë e Jugut dhe atë të Veriut⁷¹.

Lidhur më situatën e krijuar në fillim të vitit 1918 në veri të Shqipërisë, presidentit Wilson filluan t'i vijnë akuza kundër politikës që ndiqte pas mbarimit të luftës Nikolla Pashiqi.⁷² Anëtarët e KMKK me qendër në Shkodër dhe me kryetar Hoxhë Kadrinë, protestojnë kundër sulmit të njësive jo të rregullata të armatosura të Malit të Zi në zonën e Plavës dhe Gucisë më datë 4.12.1918. Anëtarët e Komitetit e luten Wilsonin që në emer të humanizmit dhe nderit të dergojë një njësi të forcave ndërkombëtare në këto zona⁷³. Kësaj letre iu pergjigj pas një muaji këshilltari i Ambasadës Amerikane në Paris, të cilin presidenti amerikan Wilson e udhëzoi që t'u shprehë anëtarëve te Komitetit besimin për shqetësimin e tij rreth situatës në këtë zonë⁷⁴. Shkaku i kësaj vonese në përgjigje kishte mund të jetë fakti se letra-protestë, u dërgua nëpërmjet qeverisë italiane. Sekretari i Presidentit Wilson ishte shumë pedant lidhur me korrespondencën e presidentit Wilson madje edhe kur bëhëj fjalë për letra të personave privatë.⁷⁵ Po ashtu edhe Luigj Bumci, në cilësinë e

⁷⁰ The Adriatic Review, Mars 1919, Boston. f. 241.

⁷¹ The Adriatic Review, Mars 1919, Boston. f. 242.

⁷² Silajxhiq H. f. 116.

⁷³ Dosje e Wilsonit, Letër e Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" dërguar Wilsonit, Shkodër 10.12.1919.

⁷⁴ Po aty, Letër e Ambasadës amerikane në Paris, dërguar "Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", Paris 15.01.1919.

⁷⁵ Po aty, Letër e Ambasadës Amerikane në Paris, dërguar Ambasadës Italiane në Paris, 2.1.1919.

kryetarit të delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, proteston tek Wilsoni ndaj krimeve të kryera mbi popullsinë e Pejës, Gjakovës dhe Plavës e Gucisë. Ai i dërgon edhe listën e viktimave të zonës së Rugovës dhe kërkon që trupat amerikane të futën në këtë zonë⁷⁶.

Në anën tjetër Pashiqi dërgoi protesta për aksionet e trupave italiane "të ndihmuara nga pasuesit e tyre shqiptarë" në anën e majtë të lumit Drin. Ai kërkon ndalimin e përparimit të trupave italiane në drejtim të Shqipërisë⁷⁷.

Pashiqi këto aksione i lidh me veprimet e komitëve në Maqedoni, që përfitojnë nga fakti se trupat serbe janë të angazhuara në kufirin me Shqipërinë⁷⁸. Për sa u përket aksioneve italiane, shumica e diplomatëve amerikanë rekomandonin që informacionet që vinin nga Franca, Serbia ose Greqia të shiheshin me rezervë, pasi që prej tyre Departamenti i Shtetit mund të priste çfarëdo gënjeshtresh, po të kihet parasysh se ekziston një marrëveshje ndërmjet këtyre tri vendeve që ka për qëllim të ndalojë depertimin e influencës italiane në Ballkan⁷⁹.

Informacionet kontradiktore nga Mali i Zi në pranverën e vitit 1919 i detyruan, aleatët të ndërmarrin diçka për të mënjeluar komplikacionet e reja. Propozimi i parë ishte që atje të dërgoheshin trupat amerikane. Këtë propozim e bënë anglezët dhe francezët, por ai nuk u pranua nga vetë amerikanët⁸⁰. Pas kësaj delegacioni anglez dhe ai amerikan erdhën në përfundim se për të provuar të vërtetën mbi situatën në Mal të Zi, duhet të dërgohët atje një komision anglo-amerikan. Presidenti Wilson emëroi si përfaqësues të amerikanve vetë kolonelin Sherman Majls⁸¹. Ky i fundit mori detyrën të hetojë situatën politike në Mal të Zi dhe sipas urdhrit të qartë të vetë shefit të Departamentit të Shtetit Robert Lansing, të provojë vërtetësinë e informacioneve mbi situatën e rëndë të popullsisë shqiptare në zonën e Plavës, Gucisë, Pejës,

⁷⁶ Letër e delegacionit shqiptar dërguar presidentit Wilson, Paris 3.6.1919.

⁷⁷ Po aty, Letër e Pashiçit dërguar Georges Clemenceau 10.4.1919.

⁷⁸ Po aty, Letër e Pashiçit dërguar Georges Clemenceau 9.4.1919.

⁷⁹ Po aty, telegram i Departamentit të Shtetit (nënshkruar nga Philips) delegacionit amerikan në Paris 27.03.1919

⁸⁰ Letër e Pashiçit dërguar Georges Clemenceau 9.4.1919.

⁸¹ Telegram i Departamentit të Shtetit (nënshkruar nga Philips) delegacionit amerikan në Paris, 27.3.1919

Gjakovës dhe Rozhajës⁸². Në informacionin e parë mbi situatën politike në Mal të Zi, koloneli Majls lajmëron se trupat serbe e kanë situatën nën kontroll, por në afërsi të Tivarit trupat rojaliste malazeze të ndihmuara nga popullsia shqiptare e kësaj zone, bëjnë rezistencë. Ai është i mendimit se "dëshirat e vërteta politike të popullit është e vështirë të përcaktohen pa pasur praninë e trupave britanike ose amerikane, por ai deklorohet për përfshirjen e Malit të Zi në përbërje të shtetit jugosllav, me kusht që qeveria jugosllave t'i garantojë Malit të Zi autonominë lokale⁸³. Në lidhje me kufijtë ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, ai propozon që kufiri duhet të pëvijohet me kujdes përgjatë vijës tradicionale kufitare, që përfaqëson kufirin edhe për njërin edhe për tjetrën palë. Majls lejon disa modifikime për arsye gjeografike por njëri nga këta dy popuj mori pjesë në luftë, ndërsa tjetri jo⁸⁴

Duke informuar për çështjen e gjenocidit ndaj popullsisë shqiptare, Majlls vë në dukje se e vetmja dëshmi për të ishin refugjatët shqiptarë që i takoi në Shkodër. Mbi bazën e informacioneve të këtyre të fundit ai arriti në përfundimin se ndërmjet 15 dhe 25 dhjetorit 1918 janë djegur rreth 138 shtëpi, plaçkitur rreth 400 shtëpi, në Rozhajë janë vrarë 700 njerëz, të cilët nuk kanë bërë asnjë rezistencë, në Plavë dhe Guci në një hark kohor prej dhjetë ditësh, janë vrarë 333 gra, fëmijë dhe pleq. Të mohosh krimet është budallallëku më i madh, shkruan Majlls, duke shtuar se është "fakt i pamohueshëm" që në Shkodër ka rreth dy mijë e pesëqind refugjatë nga Mali i Zi. Njerëz që gjithmonë kanë jetuar në këto anë nuk do t'i linin në asnjë mënyrë shtëpitë e tyre, në atë të ftohtë të madh, po të mos kishin qenë të detyruar ta bënë atë.⁸⁵ Nga korrespondenca ndërmjet Wilsonit dhe Lansingut mund të konkludojmë se Wilsoni tregoi interes për këtë çështje dhe se personalisht, duke emëruar kolonelin Majls si përfaqësues amerikan në komisionin anglo-amerikan, mori pjesë aktive në sqarimin e situatës faktike. Robert Lansingi cili ishte i mendimit së vendimi përfundimtar nuk duhej marrë pa konsultimin me informacionet e kolonelit Majls, në konkluzionin përfundimtar që i dërgoi Wilsonit thotë së kjo gjendje vërtetohet edhe nga burime të tjera

⁸² Papers, Paris Peace Conference, 1919 vol XII f.738.

⁸³ Papers, Paris Peace Conference, 1919 vol XII f.740.

⁸⁴ Papers, Paris Peace Conference, 1919 vol XII f.738

⁸⁵ Papers, Paris Peace Conference, 1919 vol XII f.741-3.

``dhe se zgjidhja e çështjes së Malit të Zi që u përgjigjet më shumë dëshirave të popullsisë, është përfshirja e tij në Jugosllavi, me garantimin e autonomisë dhe mbrojtjen e të drejtave lokale``⁸⁶

Është e kuptueshme se të gjitha zgjidhjet e propozuara që kishin të bënin me mandatin, duhet të miratoheshin nga vetë presidenti Wilson, që ato të bëheshin të plotfuqishme. Nga ana e tij Wilsoni nuk u deklarua kundër mandatit mbi Shqipërinë. Ai, si dhe shumica e qeveritarëve të Konferencës së Paqes, ishte i mendimit së Shqipërisë duhet t'i caktohet një mandator, por nuk i shihte ShBA-të në këtë rol. Sipas mendimit të tij Greqia dhe Serbia ishin tejet të përziera në problemet që kishin të bënin me Shqipërinë, ndërsa as Franca dhe as Britania, po sipas tij, nuk do ta pranonin mandatin. Mbetej që për këtë rol të ishte më e përshtatshme Italia⁸⁷ më këtë u zgjidh edhe çështja e mandatit amerikan mbi Shqipërinë, megjithëse gjatë vitit 1920 ka disa informacione se amerikanët po interesohen për gjendjen në Shqipëri dhe po shqyrtojnë problemin e marrjes pjesë në zhvillimin e saj në baza që hyjnë në kategorinë e një mandati. Nga një dokument mesojmë se një përfaqësues diplomatik amerikan në Selanik bisedoi me anëtarët e qeverisë shqiptare, ku u deklarua se shqiptarët, në rast së do të njiheshin kufij të vitit 1913 do t'u besonin amerikanëve drejtimin e doganave, në mënyrë që të tregonin vullnet të mirë dhe besim⁸⁸. Çështja e mandatit amerikan mbi Shqipërinë ishte e kushtëzuar nga zhvillimi i ngjarjeve pas LPB-së, kur Shqipërisë i kërcenohëj rreziku që të ndahej ndërmjet shteteve fqinje dhe Italisë. Traktati i fshehtë i Londrës i vitit 1915 është një pohim i qartë i këtij fakti. Shqiptarët dhe jo vetëm ata shihnin te presidenti Wilson dhe te Amerika të vetmen mundësi mbrojtjeje nga politikat e fuqive evropiane, diplomacitë e të cilave, për inerci të diplomacisë së vjetër dhe sipas ligjit të së drejtës së fituesit, llogaritnin ndarjen e territoreve të kontestueshme. Në këtë drejtim emigrantët shqiptarë në Amerikë luajtën një rol të rëndësishëm në fushatën në favor të një mandati amerikan ndaj Shqipërisë duke e mbështetur në gjithëqça delegacionin zyrtar shqiptar në Paris, pa mbështetjen e tyre nuk do të ishte e mundshme të këtë aktivitet kaq të dendur të delegacionit shqiptar. Shihet qartë se të gjithë

⁸⁶ Papers, Paris Peace Conference, 1919 vol XII f.744.

⁸⁷ The Paris Peace Conference, 1919, vol IV, f.78.

⁸⁸ N.A., 875.(K)/52.

përfaqësuesit shqiptarë ishin për një ndërhyrje amerikane në Shqipëri, dhe nëse pati mendime të ndryshme, këto ishin vetëm për kohëzgjatjen dhe gjerësinë e kompetencave, pra, për detyrat e të drejtat e mandatorit.

Me gjithë përpjekjet e shumta të shqiptarëve në rrugën diplomatike në Konferencën e Paqes në Paris pala amerikane e mbeshteste pak më shumë së të tjerët Shqipërinë dhe shqiptarët mendonin së vetem amerikanët mund të jenë zëri i tyre në Konferencë. Presidenti Wilson duke parë problemet e shumta dhe pamundësinë që Amerika të ishte mandatore e Shqipërisë ai nuk dëshiroi të ngatërrohet me çështjen shqiptare, por ai e ekspozoi çështjen shqiptare nëpërmjet delegacionit amerikan në Paris. Nëpërmjet këtyre kontakteve intensive ai arriti të prishë planet e të tjerëve dhe kështu u arrit të ruhej tërësia tokësore e Shqipërisë. Kurse sa i përket Rugovës dhe Kosovës në përgjithësi bëri që të ndalej intensiteti i dhunës dhe krimeve që ushtroheshin ndaj popullatës së pambrojtur. Të njëjtën gjë do ta proklamonte edhe Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” që për njohjen e opinionit botëror për masakrat e Malit të Zi dhe të Serbisë në viset shqiptare, si dhe për çështjen e Rugovës, të Plavës e të Gucisë, më 28 shkurt 1919, edhe një herë i drejtohet me shkresë presidentit Wilson⁸⁹.

Në anën zyrtare, edhe pse të pafuqishëm, Qeveria Shqiptare e ngrente zërin e tyre pa pushim duke iu drejtuar diplomacisë së kohës me kërkesa të parreshtura, Duhet përmendur këtu se Qeveria e përkohshme e Durrësit, nga e cila kishte dalë përfaqësia e lartpërmendur, nuk ishte njohur nga Lidhja e Kombeve.⁹⁰ Kjo përfaqësi, për fatin e keq të saj, nuk u mbështet nga asnjëra prej fuqive fituese negociuese dhe, duke pasur parasysh këtë fakt, si dhe për arsye të gjendjes jo të mirë shëndetësore të Turhan Pashë Përmetit u caktua një delegacion i dytë, i cili do të kryesohej nga Imzot Luigj Bumçi me Atë Gjergj Fishtën OFM si sekretar të tij dhe pjesëtarë të tjerë të delegacionit ishin: Mehdi Frashëri, Luigj Gurakuqi, Mihal Turtulli, Lefter Nosi, Mehmet Konica etj.⁹¹ Luigj Bumçi që në fillim, së bashku me Gjergj Fishtën, iu drejtuan Romës për të biseduar me Papën Benedikti XV, i cili ishte shumë i interesuar për

⁸⁹ Culaj L. 1997, f. 81.

⁹⁰ Peters M, 2010, f. 30.

⁹¹ Po aty, f. 30.

Shqipërinë, ngaqë me mbarimin e Luftës së Parë Botërore ishte ndërprerë edhe protektorati austro-hungarez.⁹² Roli i Imzot Bumçit në zgjidhjen e çështjes shqiptare, në atë Konferencë, si kryetar i delegacionit zyrtar shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, u shtua së tepërmi. Luigj Bumçi, me cilësinë e kryetarit të delegacionit shqiptar në Paris, protestoi te presidenti Wilson për krimet e kryera nga serbët mbi popullsinë e Pejës, Gjakovës, Plavës e Gucisë. Ai i dërgoi atij listën e viktimave në zonën e Rugovës dhe kërkonte që trupat amerikanë të futeshin në këtë zonë. Për ato krime ai vetë kishte qenë dëshmitar qysh nga viti 1911. Atë Gjergj Fishta, sekretar i Bumçit atë kohë, vepron sipas një programi të caktuar e të mirë menduar dhe udhëton për në Londër ku zhvillon takime me argjipeshkvin e Londrës e prej aty nisat për në Amerikë, për takime me diasporën shqiptare atje dhe me politikanë të ndryshëm.⁹³ Gjatë kësaj kohe territoret e Shqipërisë i kërcënonte Marrëveshja Tittoni-Venixellos, sipas së cilës Korça dhe Gjirokastra duhej t'i dorë zoheshin Greqisë. Në Lidhje me marrëveshjen Tittoni-Venixellos, duhet të thuhet se ajo ishte bërë më 29 korrik⁹⁴ që i binte afërsisht një muaj pasi Luigj Bumçi ishte bërë kryetar i delegacionit shqiptar në këtë konferencë.⁹⁵ Imzot Luigj Bumçi ndodhej para vështirësish të mëdha, pasi e dinte mirë qëndrimin që do të mbanin Fuqitë e Mëdha karshi Shqipërisë. Ai vendos të veprojë më përpara në instancën më të lartë të Kishës Katolike, në Vatikan, ku në ditët e para të janarit të vitit 1920 takohet me Papën, takimin që ia kishte

⁹² Po aty.

⁹³ Po aty.

⁹⁴ Sipas vetë Luigj Bumçit, "Me 9 Tetuer t. asajë vjetë fletorja "Il Giornale d'Italia" lajmon çiltas se "mbas akordit Tittoni-Venizelos dy Provinçet Shqyptare, Korça e Gjinokastra do t' Iepen Greqis" dhe "Me 9 Nanduer po ajo gazette boton prep ato fjalë d.m.th. ""mbas acordit Tittoni-Venizelos, Korça e Gjinokastra do t'i dorxohen Greqis" dhe "prep me 9 Dhjetiter 1919 fletorja "Il Giornale d'italia" I perseritë po ato fjalë mbi Korçen e Gjinokastren" "Letra e Imzot Luigj Bumçit drejtuar Fishtës më ^ 30. Mars 1934". Në *Hylli i Dritës VjX. Mâj. Nr 5. 1934.*, f. 220.

⁹⁵ Luigj Bumçi për këtë marrëveshje shkon e takohet më 26 tetor 1919 në Paris personalisht me ministrin e jashtëm Italian dhe e pyet: "Masijam zgiedhë kryetari I Dërgatës Shqiptare, interesa na ka pru te ju, e në mënyrë të posaçme kishim me dëshirue me dijtë ndoj send për mi marrëveshje t'uej me zotin Venizellos, mas të cilesmarrëveshje dy provinca të shqipnisë Korça e Gjirokastra do të kalojshin në Greqi , Duka, 1999, f. 299

propozuar edhe Myfit Libohova.⁹⁶

Bota s'ka mbetë vetun në Itali e në Francë

Bisedën e takimit që pati me papën, Bumçi e boton 14 vjet më vonë në revistën *Hylli i Dritës*: *"tesh pra Shênjtni të gjith misât e mërgatës Shqiptare qijanë nëParis e qi shumica asht mysliman më kanë çue ktu përpara ShêjtnisS'Uej e të gjithë për një gojë U luten qi me fuqinë T'Uej morale e meinflucën e madhe qi kenë në boten mare, të na epni ndihmën t'Uej tëvlefshme si e ku dini Ju Vetë, qi të na pështojnë dy provincet shqiptare Korça dhe Gjirokastra, të cillât janë në rrezik prej akordit Tittoni- Venizellos".⁹⁷ Mbasi Bumçi i mbaron fjalët e tij Papa nga ana e tij, i përmend atij që Vatikani në ato momente nuk kishte marrëdhënie fort të mira me qeveritë e Francës dhe atë të Italisë, por Bumçi i kujton Papes se *"bota s'ka mbete vetun në Itali e në France, - ka në botë edhe Angli e Shtete të Bashkueme t'Amerikës"*⁹⁸. Pas kësaj bisede Papa i premtonte Imzot Bumçit se do të përpiqet për shpëtimin e dy provincave shqiptare, duke u takuar me ambasadorin eAnglisë dhe me atë të Shteteve të Bashkuara në Vatikan, duke shtuar se *"Zoti ka me e ba mire s prei Konferencet të Parisit mos pritni punë të mira pse Zotin e kanë qitë jashtë dhe e aty kû s'asht Zoti drejtësia s ' mundet me këndë."*⁹⁹ " Bumçi gjithashtu ia le Papes edhe një memorandum të shkruar, me qëllim që ai të mos harronte çështjen kombëtare të Shqipërisë dhe kështu kthehet, se bashku me Mehdi Frashërin, në Paris,ku po i priste Delegacioni Shqiptar dhe anëtarët e delegacionit të entuziazmuar fillojnë e thërrasin: *"Rroftë Papa! Korça dhe Gjirokastra shpëtuan."*¹⁰⁰ " Ky takim çoi në mundësinë që grupi katolik në parlamentin italian të kërkonte nga*

⁹⁶ Letra e Imzot Luigj Bumçit drejtuar Fishtës më 30. Mars 1934". Në *Hylli i Dritës Vj X.Maj.Nr 5. 1934.*, f. 220.

⁹⁷ Letra e Imzot Luigj Bumçit drejtuar Fishtës më 30. Mars 1934". Në *Hylli i Dritës Vj X.Maj.Nr.5. 1934.*, f. 221.

⁹⁸ Letra e Imzot Luigj Bumçit drejtuar Fishtës më 30. Mars 1934". Në *Hylli i Dritës Vj X.Maj.Nr.5. 1934.*, f. 221.

⁹⁹ Letra e Imzot Luigj Bumçit drejtuar Fishtës më 30. Mars 1934". Në *Hylli i Dritës Vj X.Maj.Nr.5. 1934.*, f. 221.

¹⁰⁰ Letra e Imzot Luigj Bumçit drejtuar Fishtës më 30. Mars 1934". Në *Hylli i Dritës Vj X.Maj.Nr.5. 1934.*, f. 222.

kryeministri italian i atëhershëm. Françesko Niti (Francesco Nitti), moscopëtimin e Shqipërisë.¹⁰¹ Por, menjëherë pas kësajveriu i Shqipërisë po kërcënohej nga Serbia, e cila donte që Shkodra t'i kalonte territorit të Jugosllavisë dhe, gjatë kësaj kohe, në fund të janarit 1920, në Lushnjë, mbledhet një kongres që formon një kundërqeveri ndaj asaj të Durrësit.¹⁰² Pranë Konferencës së Paqes në Paris, Kongresi i Lushnjës paraqet një këshill regjent të përbërë nga Aqif Pasha, Dr. Mihal Turtulli, Luigj Bumçi dhe Abdi Toptani.¹⁰³ Gjatë pranisë së tij në Paris Luigj Bumçi mban një fjalim prej 29 faqesh në auditorin e Universitetit Katolik të Parisit, ku, ndër të tjera, thekson: *"Tashti Zotnij mbasi ju kam tregue, Kush janë shqiptaret e ç' janë ata, duhet t'jit flas për t'drejtat e tyne E unpo ju tham se Shqiptart kan t'drejtën e a) pamvarsis politike dheekonomike e këte*

b) në kufijt gjeografik e tenologjik të Shqipnisë (...) Okupacionet e hueja dhe intrigat e panumërta të diplomacisë se pashpirt e zemër kanë ndryshue e shëmtue jashtëzakonisht fizionominë gjeografikee etnologjike të Shqipniësë.

Duke iu referuar të drejtës së popujve për vetëvendosje dhe duke pasur parasysh këtu edhe Kosovën, Luigj Bumçi kërkonte një shtet me territor homogjen që do të shtrihej në trevat të tij të plota etnike. Ndërhyrjet e Bumçit te Papa filluan të japin rezultatet e tyre të para, pasi më 6 mars 1920, presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Wilson, dërgon një note në Paris, ku shprehet se integriteti territorial i Shqipërisë dhe sovraniteti i saj me kufijtë e vitit 1913 janë të paprekshme. Një rezultat tjetër i mëtejshëm shumë i rëndësishëm që i dedikohet. jo vetëm Luigj Bumçit në veçanti por edhe të gjithë klerit katolik shqiptar në përgjithësi, ishte njohja e Shqipërisë nga Vatikani, i cili dërgon, më 12 nëntor 1920, delegatin apostolik Ernesto Cozzi dhe më 17 dhjetor Lidhja e Kombeve njeh Shqipërinë si shtet sovran.¹⁰⁴ Ky kontribut shumë i madh i klerit, duke theksuar këtu meritat e Imzot Luigj Bumçit, nuk u mor në konsideratë nga shteti e mëvonshëm shqiptar dhe nga historiografia shqiptare pati një heshtje të gjatë. Vdekja e Luigj Bumçit

¹⁰¹ Duka, 1999, f. 300. *Krahaso edhe: Peters. 2010, f 31.*

¹⁰² Duka, 1999, f. 300. *Krahaso edhe: Peters 2010, f 31.*

¹⁰³ Po aty.

¹⁰⁴ Po aty f.32.

në tortura dhe dhunimi i varrit të Atë Gjergj Fishtës, ky ishte shpërblimi që shteti komunist u dha dy figurave kaq të mëdha patriotike. Kontributi i tyre në lidhje me çështjen që përmendëm më sipër, në historiografinë shqiptare në vitet e diktaturës, injorohet krejtësisht. Këtu e kemi tjalën kryesisht për vepra të kohës së monizmit, si "*Histori e Shqipërisë. Vëllimi i Dytë*. Tiranë 1965", ku emri i Luigj Bumçit përmendet fare shkurt në faqet 469, 472, 532, duke mos vënë në pah punën e tij diplomatike në shërbim të kombit shqiptar. " Po ashtu edhe tek "*Historia e Shqipërisë. Vëllimi i Tretë*. Tiranë, 1984" Luigj Bumçit vetem sa i përmendet emri si pjesëtar i delegacioneve të lartpërmendura¹⁰⁵.

Por nuk ishin vetëm institucionet shtetërore që po vepronin pa ndërprerë, por edhe shoqatat dhe organizatat panshqiptare dhanë kontribut crucial në dinamikën e sensibilizimit politik dhe ndihmuan Qeverinë Shqiptare në të gjitha format. Me datën 4 Korrik 1918 Peshkopi Noli, i cili përfaqësonte Federatën Panshqiptare "Vatra" si dhe përfaqësues të tjerë kombesh të vogla e shoqëruan Presidentin Uillson në Jahtin Presidential Mayflower për tek varreza e Gorge Washingtonit në Malin Vermon. Në këtë datë të shënuar, presidenti Uillson deklaroi 14 principet e nacionalizmit dhe vetëqeverisjes së kombeve të vogla. Më pas Fan Noli u takua me Presidentin në Mayflower për të folur në emër të pavarësisë së Shqipërisë. Në atë takim Presidenti Uillson i tha Fan Nolit: Unë do të kem vetëm një zë në Konferencën e Paqes dhe atë zë do ta përdor në emër të Shqipërisë. Presidenti ishte i impersionuar thellë nga telegramet dhe letrat që kishte marrë nga shqiptarët për pavarësinë dhe ruajtjen e territorit të Shqipërisë. Konferenca e Paqes e njohu Shqiperinë si një komb me vetëqeverisje të ligjshme brenda kufijve të vendosur më 1913 dhe i urdhëroi ushtritë e vendeve fqinjë që të largoheshin menjëherë prej territorit të saj. Fan Noli, si perfaqësuesi i "Vatrës" deklaroi: "Presidenti Wilson bëri më shume se askush tjetër për pavarësinë e Shqipërisë; Uillsoni refuzoi kategorikisht të nënshkruante marrëveshjen deri sa u siguria në të drejtën vetëqeverisëse të shqiptarëve" Gjatë një interviste të Nolit që shihet në një leter të Shoqatës Panshqiptare "Vatra" drejtuar M. Konicës, të datës 30 korrik 2018, Noli interviston ish-

¹⁰⁵ *Histori e Shqipërisë*. 1984. Në këtë vepër emri i Luigj Bumçit përmendet fare shkurt në faqet 193,200,201,211,257.

Presidentin Roosevelt më 25 korrik 1919 ne Harward Club ne New York lidhur me shqiptarët ai shprehet:

Roosevelt at the Harvard Club of New York. Colonel Roosevelt gave him this message for the Albanians: " I believe that Albania's independence must be restored under the joint protection and guarantee of America, England and France. I shall be glad to do anything in my power to achieve such a result."

Teksti ; ``*I believe that Albania's independence must be restored under the joint protection and guarantes of America, England and France. I shall be glad to do anything in my poëer to achieve such a result.*``

Unë besoj se pavarësia e Shqipërisë duhet të rikthehet nën mbrojtjen e përbashkët dhe garancitë e Amerikës, Anglisë dhe Francës. Do të isha i lumtur të bëj gjithçka në fuqinë time për të arritur një rezultat të tillë. Fan S. Noli do të deklaronte pas takimit se ish Presidenti Roosevelt çuditërisht ishte shumë i informuar dhe në detaje mbi Shqipërinë dhe ngjarrjet e ndodhura atje. Ndër të tjera Roosvelt i kishte thënë Nolit” Shqiptarët i dua dhe i admiroj, se janë një racë e vjetër dhe trime që meriton të shpëtohet dhe të vetëqeveriset. Di që në shumë raste, turqit, grekët dhe serbët bashkoheshin dhe lidheshin mes tyre që t’u bënin ballë shqiptarëve. Di pastaj që shqiptarët janë besnikë dhe të ndershëm, dhe kur e japin fjalën, e mbajnë si burra...¹⁰⁶. Pra, vetem SHBA ishin shpresa e vetme e shqiptarëve ajo mund të bëhej dashamirëse e Shqipërisë vetëm kur sllavët e grekët të ishin të tillë. Sipas Paskal Milo delegatit anglez, Eyre Crowe, pohon: Jugosllavia do të mund ta përdorte Shqipërinë si një "leve ne mënyrë krejt të ligjshme", për të shkëputur koncesione nga Italia". Shqipëria vihej kështu në pozitën e vjetër e të preferuar të Fuqive të Mëdha, në atë të monedhës se këmbimit e të plaçkës së tregut.¹⁰⁷ Të ndodhur përball[rezikut përmanent nga të gjitha anët edhe jugu i Shqipërisë kërkonte prezencën amerikane. Prapaskenat e qarqeve politike franceze detyruan delegacionin shqiptar t'i drejtohet me një shkresë G. Clemenceau-t, kryeministër dhe ministër i Luftës i

¹⁰⁶ Gazeta Dielli e 26 gushtit 1918.

¹⁰⁷ Milo P. 1991, f.126.

Francës, njëkohësisht kryetar i Konferencës së Paqes. Në të shprehej dëshira e banorëve të Korçës dhe të Starovës për vazhdimin e administrimit freng, duke analizuar rrezikun e depërimit të ushtrive greke e serbe. Por, në rast largimi të okupatës franceze, delegatët shqiptare sugjerorin ardhjen e një kontigjenti ushtarësh amerikanë deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Korçës.¹⁰⁸ Ndihmën e SHBA – së përveç shqiptarëve e kërkuan edhe bullgarët. Delegacioni bullgar shpresonte të mbështetja e SHBA-së, e cila, për fat të keq, hoqi dorë nga angazhimet e saj në Evropë kur u diskutua çështja bullgare.¹⁰⁹ Refuzimi i Aleatëve anglofrancezë vjen si pasojë e asaj që Bullgaria kishte bashkëpunuar me Gjermaninë dhe Austro-Hungarinë. Studiuesja Esilda Luku shprehet në favor të asaj që orientimeve të gjeopolitikës evropiane ndaj çështjes shqiptare nuk iu bashkua presidenti Wilson, i cili s'mund të pranonte:

- 1) kushtet e Traktatit të Fshehtë të Londres (1915);
- 2) zbatimin e parimeve të diplomacisë së vjetër dhe
- 3) nënshkrimin e kompromisit të 14 janarit pa praninë e delegatit amerikan.¹¹⁰

Pra me një fjalë SHBA-ja u anashkalua nga Ballkani, por ajo erdhi e u bë gurë këndi dhe faktor vendimmarrës në proceset dhe zhvillimet botrore për t'u bërë superfuqia më e madhe e kohës. Pasi që roli i SHBA-ve në Ballkanin e ndarë në shumë sfera të interesit bëri që ato të terhiqen nga Ballkani përkatësisht nga shqiptarët dhe të pezullojnë praninë e tyre direkte. Por ato u pozicionuan fuqishëm në mbështetje të rregullimit të drejtë të çështjes shqiptare dhe siç do ta shohim më vonë ato do të kthehn fuqishëm duke e rekuperuar edhe boshllëkun e mungesës së saj, sidomos me nderhyrjen e Luftës së fundit në Kosovë duke shpëtuar një katastrofë njerëzore.

¹⁰⁸ AMPJ, V. 1919, D. 9, FI. 269 (*Raporte, promemorje dhe korrespondencë e Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris si dhe përfaqësuesve të Shteteve të Mëdha mbi gjendjen në Shqipëri, luftën për mbrojtjen e pavarësisë, integritetit tokësor. Kërkohej të mbrohen të drejtat dhe interesat e Shqipërisë kundër qëllimeve të shteteve fqinjë etj për copëtimin e Shqipërisë.*

¹⁰⁹ Macmillan M. 2006, f. 172-173.

¹¹⁰ Luku E. 2012, f. 24.

**Prof. Dr. Asoc. Dr. Arben Arifi,
Kolegji, “UBT”, PRISHTINË**

**ALBANIAN REQUEST IN PARIS, IN 1919, FOR THE ARRIVAL
OF THE AMERICAN ARMY IN RUGOVA, PLAVA AND GUCIA,
TO STOP THE SERBIAN AND MONTENEGRIN MASSACRES**

SUMMARY

The First World War- WWI had serious consequences for Albanians. Albania, as a fragile state created in 1912, had the misfortune of being involved in the Balkan wars without making it a full year since her independence. The vast majority of Albanians were outside the Albanian state without protection and oppressed both by the Ottoman Empire, which was counting its last days, as well as by the neighboring countries. Even geopolitics was against them. During the WWI, the Albanians had the misfortune of being prey to the appetites of the neighboring countries, and as a result of the lack of support from the great powers, they suffered severely. The inhabitants of Rugova, Plava and Gucia and other regions on the Montenegrin border became the target of attacks and a savage campaign accompanied by expulsions and horrific massacres that culminated on February 16, 1919. This was among the most savage and anti-human massacres that Serbs and Montenegrins make over these parts. Seeing that the massacres have not stopped, the entire Albanian political spectrum and the entire people came to their defense. But this was insufficient because the major European powers did nothing to stop the violence and the only hope was the USA. In this context, many demands were directed towards President Wilson that the US should be mandated in the establishment of peace and security because they were the only ones that the Albanians trusted and they were the only voice of impartial justice based on the principles of democracy and human rights.

Burimet dhe Literatura

a) Burimet arkivore

- *AMPJ*, V. 1919, D. 9, FI.269.
- *AQSH*, Fondi “Hoxha Kadriu”, dosja nr. 2, dok. nr. 708197,
- *AQSH*, Fondi nr. 846, viti 1919, dosja 13. Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, Paris 15.1.1919; Letër e delegacionit shqiptar dërguar presidentit Wilson, Paris 3.6.1919; Letër e Pashiçit dërguar Georges Clemenceau 9.4.1919; Letër e Pashiçit dërguar Georges Clemenceau 10.4.1919.
- *Arkivi i Institutit të Historisë*, Tiranë (AIH), A.V.51, FI. 66 (Shqipëria nga Hodgson, Londër, prill 1944).
- *Arkivi i MPJ Italiane*, Telegrafi i Ministrisë së Jashtme Italiane dërguar Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë, Ministrisë së Luftës dhe Legatës Italiane në Beograd, nr.33993, Rom 10 dhjetor 1919, Zarfi nr.683, Dosja alb 105/1, viti 1919-1930; Dosja 10, Kërkesat e kyetarit të Qeverisë së Përkohshme Turhan pashë Përmeti në emër të Delegacionit Shqiptar drejtuar Konferencës së Paqes së Parisit, datë 12.2.1919, viti 1919, nr.50.948; Telegram i kyetarit të Qeverisë së Përkohshme Turhan pashë Përmeti dërguar Presidentit të Amerikës, datë 3.1.1919, viti 1919. *Troubled Neighbours: Franco-British Relations in the Twentieth Century* (London); Dokumenta zyrtare të paraqitura nga ana e Dërgatës Shqiptare nga datat 12 shkurt deri më 5 qershor 1919, të botuara nga ana e Qeverisë së Përkohshme. Kërkesat e Shqipërisë në Konferencën e Paqes së Parisit 1919 drejtuar Fuqive të Mëdha, Paris, më 12 shkurt 1919, nënshkruar nga Kryetari Turhan pashë Përmeti; Dosje e Wilsonit, Letër e Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare” e Kosovës dërguar Wilsonit, Shkodër 10.12.1919; Dosje e Vudrov Wilsonit Kamburi Lansingut, datë 07.0.1919; Dosje e Vudrov Wilson, Letër

e Adhamidhit dërguar Wilsonit, Paris, 17.3.1919; Telegram i Departamentit të Shtetit (nënshkruar nga Philips) delegacionit amerikan në Paris, 27.3.1919.

- The Adriatic Review, Mars 1919, Boston. Papers Relating to the Foreign Relations of the United States, The Paris Peace Conference, 1919, Volume IV, Editor: Joseph V. Fuller; United States Government Printing Office Washington 1943.
- Elsie, Robert(2009). British Foreign Office document FO 608/46, preserved in the National Archives at Kew, U.K.

b) Bibliografia

- Adler. J. (1997). L'Union forcée – la Croatie et la creation de l'état yougoslave, 1918, Geneva.
- Bolovan L., O. M. T a m a s (2020). *World War I and the Birth of a New World Order*, The End of an Era Cambridge.
- Bashkurti, Lisen (2003). *Shqiptarët në rrjedhat e diplomacisë: nga universalizmi tek Lufta e ftohtë*, Geer, Tiranë.
- Bradford H.N. "The Balance in the Balkans" (International Review, February 1919).
- Braha, Shaban (1991). *Gjenocidi serbomadh dhe Qëndresa shqiptare*, Shtëpia botuese "Lumi-T", Gjakovë.
- Bumçi, Luigj (1920). *Shqyptarët e të drejtat e tyre*, "Shtypshkonja Franciskane", Shkodër.
- Cabanes, Pierre, Chaline, Olivier, Doumerc, Bernard, Ducellier, Alain, Sivignon, Michel (2005). *Historia e Adriatikut*. "Shtëpia e Librit dhe e Komumkimit", Tiranë.
- Culaj, Lush (1997). *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, 1918-1924*, Prishtinë, Instituti Albanologjik.
- Culaj, Lush (2010). "Çështja shqiptare në Konferencën e Parisit 1919-1920", Prishtinë, Instituti Albanologjik.
- Çami, Muin,(1978). "Armëpushimi i vitit 1918 dhe Shqipëria", *Studime historike*, nr.4, Tiranë.

- Duka, Valentina (1999). "Roli i Klerit Katolik Shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris (1919-1920)", Krishtërimi ndër Shqiptarë, Simpozium Ndërkombëtar, Tiranë.
- Duka, Valentina (2007). *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë, "Kristalina-KH".
- Erikson, C.T. (1919). "Six Reasons Why America Should Become Mandatory For Albania", Paris.
- Evans, J. (2008). *GREAT BRITAIN AND THE CREATION OF YUGOSLAVIA, Negotiating Balkan Nationality and Identity*, Tauris Academic Studies London, New York.
- Evans, R. (2002). *Great Britain and Central Europe, 1908-1948: A Study in Perceptions*, London.
- Grume I-Jacquignon, François (1999). *La Yougoslavie dans la stratégie française de l'Entre-deux-Guerres (1918-1935)*, Berlin.
- Gulyás, László, Kétrégió – Felvidékés Vajdaság - sorsa az Osztrák – Magyar, (2005). *Monarchiától napjainkig*, Hazai Térségfejlesztő Rt. Budapest.
- Gulyás, László (2008). *Délszláv er"oközpontok államszervezési koncepcióinak küzdelme 1914–1918*, in: *Mediterrán és Balkán Fórum*.
- Gurakuqi, Romeo (2007). *Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore*, Shkodër "Camaj-Pipa".
- H.N. Bradford (1919). "The Balance in the Balkans " (*International Review*, February 1919).
- Hadri, Ali (1974). *Gjakova në LNÇ, Prishtinë*, Instituti i Historisë, Prishtinë.
- *Histori e Shqipërisë* (1984). vëllim i tretë (1912-1944), Tiranë, Pollo, Stefanaq, Bihiku, Kiç, Frashëri, Kristo, Çami, Muin, Koka, Viron, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë.
- *Historia e Popullit Shqiptar III*, Periudha e Pavarësisë (2007). Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. 2, (2002). Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Horvat, B. (1988). *Kosovsko pitanje*, Globus, Zagreb.

- Hrabak, Bogum i I(1971). "Reokupacija oblasti srpske i crnogorske drzave sa arbanaskom vecinom stanovnista", Prishtinë, *Gjurmime albanologjike*, nr 1, Instituti Albanologjik.
- Iorga, Nicola e. *Institute of History, Iorga-Pippidi Archive*, package IV.
- Jaray, G. L. (2007).*Shqipëria e panjohur. Né mbretërinë e re të Shqiptarëve*. Tiranë, Dituria.
- Juhász, J. (1999).*Volt egyszer egy Jugoszlávia, Budapest*.
- Karlo, Jean (1998).*Gjeopolitika*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Ushtrisë.
- Kissinger, Henry (1999). *Diplomacia*, Tiranë, Shtëpia botuese e Lidhjes se Shkrimtarëve.
- Kitan ics, M. (2011). *Az albán történelem mérföldkövei–a kezdetektől a bipoláris világ széthullásáig*,Balkán Füzetek – Pécs.
- Luku, Eelsida (2012). Tezë doktrature, Tiranë, *Gjeopolitika evropiane dhe Shqipëria në periudhën mes dy konferencave të paqes (1919-1946)*.
- Lybyer, A. H. (1920). The Balkan Situation,*The Journal of International Relations*, Vol. 10, No. 4 (Apr., 1920), pp. 404-424.
- Macmi Ilan, Margaret (2006).*Paris 1919, gjashtë muaj që ndryshuan botën*. Tiranë, Plejad.
- Milo, Paska I(1991).*Shqipëria dhe Jugosllavia (1918-1927)*, Tiranë, 8 Nëntori.
- N.A. Letër e Heronit dwrguar Nolit, 15.02 1918
- Noel Buxton and C. Leonard leese, 1919Balkan Problems and European Peace, New York.Papers, Paris Peace Conference, 1919 vol XII.
- Peters, Markus (2010).*Përballjet e Historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996*, Tiranë, Qendra botuese Shoqata Jezuite.
- Pushkoll i, Fehmi (1991). *Mbrojtja Kombetare Shqiptare e Kosovës 1878-1990*, Prishtinë.
- R. Gyémánt – P. Tibor (2008).*A Koszovói Köztársaság Európa legfiatalabb állam*. A Pólay Elemér Ala-pítvány Tansegédletei, SZTE-ÁJTK, Szeged.

- R.W.Seton – Watsons (1981). *Making of a New Europe, and the Last Years of Austria-Hungary*, London.
- Repisht i, Xhevat (1998). *Lufta për mbrojtjen e Shkodrës në vitet 1918-1920*. Shkodër, Camaj-Pipa.
- Swire, Joseph (2005). *Shqipëria-ngritja e një monarkie*, Tiranë, Dituria.
- *Shqipëria përballë Konferencës së Paqes Paris 1919* (2007). Botim i dytë, shtëpia botuese Uegene, Tiranë.
- Zaimi, T a h i r (1970). *Tallazet e jetës dhe lotët e zemrës*, Bruxelles.
- *Hylli i Dritës* Vj. X. Maj. Nr 5. Kuvendi Franceskan, Shkoder 1934.

c) Shtypi

- *Besa Shqyptare*, Shkodër, nr. dt 7. 11. 1918.
- *Gazeta Populli*, nr.25, datë 3 tetor 1919.
- *Gazeta Dielli*, 26 gusht 1918.